

DIMENSIONI DEMOGRAFIK I AGJENDES 2030 - PERSPEKTIVAT DHE SFIDAT E KOSOVËS



STUDIM POLITIKASH



DIMENSIONI DEMOGRAFIK I AGJENDES 2030 - PERSPEKTIVAT DHE SFIDAT E KOSOVËS

Autor: Dr.sc.Sami Behrami dhe Msc.Fadil Bajraktari

Edituan: Burim Ejupi dhe Dardan Abazi

Programi: Zhvillim i qëndrueshëm

Publikimi: Korrik 2021

Foto e ballinës: Unsplash



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockfeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja


HYRJE	2
METODOLOGJIA	4
1. EVULUCIONI I MARDHËNIVE NË MES POPULLSISË DHE MJEDISIT	5
2. ZHVILLIMI I QENDRUESHEM DEMOGRAFIK- SUSTENDEMO.....	9
3. PROCESHEVE DEMOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI I QENDRUESHËM.....	12
3.1 A janë ndryshimet demografike çelës i zhvillimit të qëndrueshëm.....	12
3.2. Struktura e popullsisë sipas moshës	13
3.3. Moshimi demografik	14
3.4. Migrimet e popullsisë	14
3.5. Urbanizimi.....	15
4. PERSPEKTIVA E PROCESHEVE DEMOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI I QENDRUESHËM- RASTI I KOSOVËS	17
4.1. Perspektiva demografike dhe zhvillimi i qëndrueshëm.....	18
4.1.1. Zhvillimi demografik i Kosovës.....	18
4.1.2. Dinamika në numrin e përgjithshëm të popullsisë.....	19
5. PERSPEKTIVA E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS MOSHËS- MOSHIMI DEMOGRAFIK	23
5.1. Moshimi demografik- definicionet dhe treguesit	24
5.2. Moshimi demografik në Kosovë	24
5.3. Perspektiva e strukturës së popullsisë sipas moshës deri me 2061- varianti i mesëm... 27	
5.4. Rritja e kontingjentit të të moshuarve.....	28
5.5. Sfidat e moshimit demografik	30
2. MIGRIMET E POPULLSISË.....	32
7. PERSPEKTIVA DHE SFIDAT NË STRUKTURËN SOCIO- EKONOMIKE	35
8. PERSPEKTIVA DHE SFIDAT NË SISTEMIN ARSIMOR	38
8.1. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit arsimor	38
8.1.1. Sa është i qëndrueshëm zhvillimi i arsimit në Kosovë.....	39
8.1.2. Institute dhe qendra kërkimore cilësore.....	42
9. DINAMIKA DHE SHKALLA E URBANIZIMIT E POPULLSISË NË KOSOVË	43
9.1. Vendbanimet urbane ne regjistrimet e popullsisë	43
9.2. Dinamika e rritjes së popullsisë urbane në Kosovë 1948- 2011	46
9.3. Shkalla e urbanizimit të popullsisë.....	49
PËRFUNDIME.....	53
REKOMANDIME	55

HYRJE

Në perspektiven e zhvillimit dhe përparimit të shoqërisë njerëzore, konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm i kushtohet vëmendje kryesore, duke e shndërruar qëndrueshmërinë si pjesën më të rëndësishme të politikave zhvillimore të të gjitha sferave të jetës qofshin ato të niveleve globale, qofshin ato të niveleve regjionale apo lokale.


Në literaturën bashkëkohore ekzistojnë definicione të ndryshme të zhvillimit të qëndrueshëm, në varësi të fushës së studimit. Megjithatë, definicioni më i përhapur dhe më gjithëpërfshirës është definicioni i Komisionit Botëror për Mjedis dhe Zhvillim i njohur si Raporti i Brundtlandit në të cilin rëndësi e veçante i kushtohet brezit të tretë . Sipas këtij Komisioni(Brundtland 1987) zhvillim i qëndrueshëm definohet si: ”..... zhvillim i cili i plotëson kërkesat e brezit të tanishëm dhe në të njëjtën kohë nuk rrezikon mundësit e brezave të ardhshëm që ti plotësojnë kërkesat e veta”.

Thënë më ndryshe, qëllimi themelor i zhvillimit të qëndrueshëm është harmonizimi në mesë kërkesave të shoqërisë (barazi, siguri, liri, socializimi...) dhe ekonomisë (industria, vendet e punës, bujqësia...) ndërsa në të njëjtën kohë të ruhet mjedisi (ajri i pastër, ujërat, toka, biodiversiteti...) etj.



Grafiku 1. Skema e zhvillimit të qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon harmonizimin në mes të faktorëve¹: ekonomike, sociale dhe mjedisore (mjedis të pastër shëndosh). Pra qëndrueshmëria krijon një ekuilibër mes natyrës dhe shoqërisë duke mbajtur në minimum efektet e dëmshme që dalin nga marrëdhëniet mes të dyjave². Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton rritje kualitative dhe zhvillim socio-ekonomik e kulturor i cili është në raport me kapacitetet e mjedisit jetësor i cili duhet të zhvillohet në mënyrë që gjeneratave të ardhshme të mos u vështirësohen (rrezikohen) mundësit e ekzistencës.



Grafiku 2. Skema e lidhshmërisë në mes nënsistemeve të zhvillimit të qëndrueshëm³

Bazuar në definicionin e zhvillimit të qëndrueshëm mundë të kuptohet se zhvillimi i qëndrueshëm nuk mundë të konceptohet vetëm si aktivitete i cili është i orientuar në ruajtjen e mjedisit dhe problemet mjedisore (konceptet e para për zhvillimin e qëndrueshëm) të botës bashkëkohore por është proces shumëdimensional me karakter global ku përfshihen edhe çështjet sociale, ekonomike, demografike, politike etj.

Agenda 2030 dhe Agenda 21 të cilat janë shndërruar në: “partneritet global për zhvillim të qëndrueshëm” dhe “program të punës për shekullin 21”, nënvizojnë peshën e zhvillimeve demografike për zhvillim të qëndrueshëm, prandaj është e domosdoshëm: inkorporimi i faktorëve dhe trendëve demografike në analizën e zhvillimit të qëndrueshëm, kuptimi më të mirë të marrëdhënieve ndërmjet dinamikës demografike dhe zhvillimit të qëndrueshëm, hulumtimin e bashkëveprimit mes faktorëve demografik dhe zhvillimit të qëndrueshëm, forcimi i programeve kërkimore që integrojnë popullsinë, mjedisin dhe zhvillimin; përcaktimi i implikimeve të tendencave dhe faktorëve demografikë në zhvillimin e qëndrueshëm kombëtar dhe lokal etj.

Duke pasur parasysh rolin dhe rendësin e proceseve demografike për zhvillimin e qëndrueshëm dhe fakti që popullsia është strukturë biologjike e shoqërisë dhe ekonomisë e të gjitha hapësirave gjeografike, është e domosdoshme që për zhvillim të qëndrueshëm të vendeve, rajoneve ose

¹ M. Dukanovic, Životna sredina i održivi razvoj, Elit, Beograd 1996, fq 173.

² Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, Punime të zgjedhura nga i. Gyulian, REC, Zyra në Kosovë, Prishtinë 2005, fq.19

³ Adams, W.M. (2006). The Future of Sustainability: Re-thinking Environment and Development in the Twenty-first Century. Report of the IUCN Renowned Thinkers Meeting, 29–31 January, 2006. (http://cmsdata.iucn.org/downloads/iucn_future_of_sustainability.pdf).

komunave në radhë të parë të sigurohet qëndrueshmëri demografike duke e shndërruar kështu qëndrueshmërinë demografike si nënsistem në sistemin e qëndrueshmërisë.

Edhe institucionet e specializuara kërkimore të Kombeve të Bashkuara, (Instituti Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Social- UNRISD dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim -UNDP), zhvillimet demografike dhe parashikimin e tyre i rendisin (të dytën) ndër gjashtë fushat kryesore për plotësimin e objektivave të Agjendës 2030. Komponentët më të rëndësishme demografike për plotësimin e Agjendës 2030, janë: trendët e rritjes së popullsisë, trendët e popullsisë sipas moshës, trendët e migracionit dhe trendët e urbanizimit⁴.

Temë trajtimi në këtë punim do të jetë roli dhe rëndësia e zhvillimeve demografike në zhvillimin e qëndrueshëm. Komponentët demografike janë bazë për progres, mbijetesë dhe zhvillim për të gjitha shoqëritë/njerizimin dhe injorimi i kësaj të vërtete themelore herët a vonë sjell rezultate negative edhe në sferat tjera të jetës, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e përgjithshme.

Pyetja themelore në të cilën është orientuar kjo analizë socio- demografike është: si ndikon situata dhe zhvillimet demografike në zhvillimin e qëndrueshëm, cilat janë implikimi e disa nga strukturat më të rëndësishme të popullsisë në zhvillimin e qëndrueshëm? Do të bëhen përpjekje në përgjigje në pyetje a mundë të ketë zhvillim të qëndrueshëm dhe arritje të Objektivave të Agjendës 2030 me paqëndrueshmëri demografike? Të gjitha këto do të analizohen me rastin e Kosovës.

METODOLOGJIA

Studimi i faktorëve demografike në raport me objektivat e Agjendës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm, ka një rëndësi të madhe për të kuptuar rolin e këtyre zhvillimeve në arritjen e këtyre objektivave. Gjendja e tanishme dhe perspektiva e këtyre zhvillimeve në rastin e Kosovës kërkon ndërmarrjen e masave të politikave popullore me qëllim që zhvillimet demografike të mos shndërrohen në pengës për arritjen e objektivave të Agjendës 2030, si imperativ i zhvillimit të botës bashkëkohore.

Për realizimin e punimit jemi përpjekur të përdorim metoda kërkimore-shkencore të karakterit teorik dhe praktik, me treguesit më të rëndësishëm të cilët na ndihmuan në arritjen e rezultateve për prezantimin e rolit dhe rëndësisë së faktorëve demografik në përmbushjen e Objektivave të Agjendës 2030, për zhvillim të qëndrueshëm.

Burimet kryesore i të të dhënave të përdorura në këtë punim janë statistikat për popullsinë të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës siç janë: statistikat e regjistrimeve të popullsisë, statistikat vitale, statistikat mbi migrimet, parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061 etj., duke

⁴ GLOBAL TRENDS, Challenges and Opportunities in the Implementation of the Sustainable Development Goals, © United Nations Development Programme and United Nations Research Institute for Social Development, 2017.

pasur parasysh ndryshimet të konsiderueshme metodologjike midis regjistrimeve. Kështu, në kuadër të metodologjisë problem paraqet edhe krahasimi jo i plotë i statistikave në dispozicion, jo vetëm për statistikën nga regjistrimet e popullsisë, por edhe për ngjarjet vitale etj., si dhe mos përfshirja e përgjithshme e popullsisë në këto statistika.

Krahas të dhënave statistikore me rëndësi ishte edhe përdorimi i literaturës së ngjashme nga autorët e huaj, që trajtojnë problematikën dhe ndërvarësinë e zhvillimit të faktorëve demografik me ndikim në përmbushjen e Objektivave të Agjendës 2030, për zhvillim të qëndrueshëm. Gjatë hulumtimit është përdorur metoda analitike dhe sintetizimi i rezultateve, kurse në mbështetje të të dhënave statistikore dhe matematike-statistikore janë paraqitur ndryshimet kualitative dhe kuantitative të popullsisë për elementet të cilat janë marr në shqyrtim. Gjithashtu, metodat analitike janë përdorur për të treguar gjendjen dhe tendencat e transformimit të komponentëve të popullsisë në Kosovë në të kaluarën e afërm, të tashmen dhe të ardhmen. Element themelor i kësaj metode janë të dhënat statistikore të periudhave të ndryshme, si dhe të dhënat e punimeve të ndryshme të kësaj natyre.

Përmes metodës së sintezës janë nxjerrë përfundime për dinamikën e popullsisë, strukturat e popullsisë, migrimet e popullsisë, zhvillimin e urbanizimit, marrëdhëniet midis dukurive e proceseve demografike, urbanizimin etj. Të dhënat statistikore shprehën në mënyrë tabelore dhe grafike për të treguar trendin e lëvizjeve sidomos të treguesve demografikë, ndërsa metoda krahasuese na mundësoi krahasimin e proceseve demografike, urbanistike etj, gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Të dhënat e këtij studimi mundë të jenë udhërrëfyes për kreatorët e politikës me rastin e përgatitjeve të strategjive sektoriale dhe nder sektoriale me qëllim të shmangies nga zhvillimet e pa favorshme demografike të cilat do të ishin pengës në rrugëtimin e Kosovës drejt plotësimin e Objektivave të Agjendës 2030.

1. EVULUCIONI I MARDHËNIVE NË MES POPULLSISË DHE MJEDISIT

Për përcaktimin e raporteve në mes popullsisë dhe mjedisit që nga kohërat e lashta e deri me sot ekzistojnë mendime, teori dhe qasje të ndryshme konceptuale që karakterizohen edhe me debat e diskutime të ndryshme nga: ekolog, demograf, ekonomist e shkencëtar të fushave tjera. Interesimi për trajtimin e raporteve popullsi- mjedis ka traditë mbi 200 vjeçare kur ndikimi i popullsisë në mjedis shndërrohet në debat të vazhdueshëm.

Termi zhvillim i qëndrueshëm për herë të parë është përdorur në sektorin e pylltarisë në Gjermani, që nënkuptonte marrëdhëniet mes prerjes dhe pyllëzimit të sipërfaqeve të prera (duhet të pritet vetëm aq sa në të njëjtën kohë mbjellën) me qëllim të ruajtjes së pyjeve edhe për gjeneratat tjera dhe lidhet me emrat H.C. von Carlowitz (1713) dhe L. Harting (1804).

Studimet e para të trajtimit të perspektives të zhvillimit të shoqërisë njerëzore mund të konsiderohen veprat e themeluesve të ekonomisë moderne (klasikëve të teorive ekonomike) Adam Smith e David Rikardo, veprat e të cilëve trajtojnë raportet e burimeve natyrore (veçanërisht tokës), rritjes demografike, prodhimit të ushqimit, përmirësimit të cilësisë së jetës etj.

Thomas R. Malthus në “Ese mbi parimin e popullsisë”(1798) në thelb ka trajtimin e problemeve demografike që lidhen me mjedisin, ku konstaton se rritja e popullsisë do të jete e kufizuar nga burimet natyrore që përbën edhe thelbin e postulatës së veprës “ rritja gjeometrike e popullsisë dhe rritja aritmetike e të mirave të jetës”, që në realitetin e kohës nënkupton shqyrtimin e raporteve komplekse në mes ndryshimeve demografike dhe aspekteve të ndryshme mjedisore. Gjysma e dytë e shekullit XX, shënon periudhën e rritjes së konsiderueshme të interesimit të demografëve për çështjet mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm, që korrespondon me kohën e rritjes së interesimit dhe literaturës me teme trajtimi rritjen demografike dhe zhvillimet.

Pas luftës së dytë botërore raportet në mes popullsisë dhe mjedisit kryesisht trajtoheshin nga këndvështrimi i bazuar në ndikimin negativ të rritjes së popullsisë në burimet jo të ripërtritshme, kapacitetet prodhues, prodhimin e ushqimit etj., duk ringjallur idenë e Malthusit. Në fuqizimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm gjatë viteve 60 dhe fillimin e viteve të 70 ndikuan: përkeqësimi i situatës mjedisore dhe publikimi i “Bomba e Popullsisë” (1968) dhe raportit i parë i Klubit të Romës “Kufijtë e Rritjes”(1972).

Një kontribut të veçantë në rendësin e raporteve popullsisë- ekonomi- mjedis = zhvillim i qëndrueshëm kanë dhënë edhe Konferencat Botërore mbi Popullsinë, sidomos konferenca e III (Bukuresht 1974) ku një ndër çështjet e shqyrtuara ishte edhe problemet e lidhura nga ndërveprimi në mes popullsisë dhe mjedisit jetësorë. Në Konferencën e IV (Meksiko Siti 1984) përveç kërkesës për përmbushjen sa më të suksesshme të obligimeve që dalin nga dokumenti e konferencës së Bukureshtit, në kudër të pesë porosive për përmbushje, për qeveritë dhe organizatave joqeveritare ishte edhe çështja e mjedisit jetësor dhe popullsisë. Në Konferenca e V (Kajro 1994) tema kryesore e trajtuar e lidhur drejtpërdrejt me problemet demografike ishte- popullsia, mjedisi jetësor dhe zhvillimi.

Në ndërkohë u organizuan edhe shume tubime që temë trajtimi kishin mjedisin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe problemet që lidhen me to duke përfshirë edhe popullsinë dhe zhvillimet demografike. E tillë ishte Konferenca e OKB-se për Mjedisin e organizuar në vitin 1972 në Stokholm, ku temë qendrore ishte ndikimi negativ i aktiviteteve njerëzore në mjedis, veçanërisht rritja e popullsisë dhe faktorëve tjerë social në rritjen e konsumit, ndikimin në mjedis dhe burimet natyrore.

Konferenca e Stokholmit 1972, paraqet organizimin e parë të nivelit më të lartë ndërkombëtarë në të cilën u tregua për rreziqet të cilat vijë për planetin nga ndotja e mjedisit në nivel global. Gjithashtu ajo që tërheq vëmendjen në Deklaratën e Stokholmit është fakti se ky është dokumenti i parë ku përmenden të drejtat e *gjeneratës së tretë*, përkatësisht të drejtën në mjedis të pastër dhe jetë të shëndetshme, duke vendosur kështu lidhjet e ngushta në mes mbrojtjes së mjedisit dhe afirmimit të të drejtave të njeriut.

Në të drejtat e gjeneratës së tretë përfshihen: 1. të drejtën grupore dhe kolektive, 2. të drejtën në vetëvendosje, 3. të drejtën në zhvillim ekonomik e social, 4. të drejtën për mjedis të pastër, 5. të drejtën në resurse natyrore, 6. të drejtën në komunikim, 7. të drejtën në trashëgimi kulturore dhe 8. të drejtën në barazë dhe qëndrueshmëri të gjeneratave.

Ideja për zhvillim të qëndrueshëm për herë të parë përfshihet në dokumentin e Strategjisë Botërore të Konservimit (*World Conservation Strategy*) e cila në radhë të parë kishte të bënte me zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor respektivisht ruajtjen e resurseve, ndërsa aspekteve tjera ekonomike, sociale, politike ishin në rend të dytë ose nuk ju kushtua vëmendje e merituar.

Një dimension i ri më gjithëpërfshirës, zhvillimi i qëndrueshëm merr në raportin *Ardhmëria e Jonë e Përbashkët* (*Our Common Future- World Commission on Environment and Development, WCED*) i njohur si Raporti i Brundtland (1987). Raporti Brundtland arriti të popullarizoj zhvillimin e qëndrueshëm duke e bërë temë dhe pjesë gati të të gjitha organizatave, agjencive të shoqatave jo qeveritare etj., botërore. Kështu, termi zhvillim i qëndrueshëm gjënë përdorim gjithnjë e më të gjerë në të gjitha fushat dhe veprimtaritë jetësore dhe bëhet pjesë e të gjitha politikave zhvillimore. Gjithë përfshirja e konceptit zhvillim i qëndrueshëm në politikat zhvillimore të të gjitha sferat e jetës, në vitin 1992, solli zhvillimin e Konferencës për Mjedis dhe Zhvillim (United Nations Conference on Environment and Development- UNCED) në Rio de Janeiru e njohur si Samiti për Tokën, rezultat final i të cilës ishte “Agenda 21”, dokumenti i cili përmban masat për “partneritet global për zhvillim të qëndrueshëm⁵. Deklarata e Rio, përbëhet nga 27 principe si udhëzues për zhvillimin e qëndrueshëm në të ardhmen në mbar planetin nga të cilët principi i parë thekson “*njerëzit janë shqetësimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm*”.

“Agende 21”, nuk është e kufizuar në konceptin tradicional të zhvillimit të qëndrueshëm i cili nënkupton ruajtjen e mjedisit por ka zgjeruar këtë koncept duke përfshira edhe aspektet ekonomike, politike dhe financiare të zhvillimit të qëndrueshëm. Kështu “Agende 21” e cila përbëhet nga katër pjesë me gjithsejtë 40 kapitujt nga të cilat 25 trajtohen tema me karakter jo mjedisor. Pjesa e parë përfshin çështje të karakterit socio-ekonomik, pjesa e dytë trajton problemet në lidhje me menaxhimin e resurseve dhe mjedisit, pjesa e tretë përfshin rolin dhe rendësin e grupeve shoqërore në zhvillimin e qëndrueshëm dhe pjesa e katërt përfshin mjetet dhe mënyrat e zbatimit të Agende 21.

Në pjesën e parë në kapitullin pesë specifikohen *roli dhe rëndësia e dinamikës demografike në zhvillimin e qëndrueshëm*, ndërsa në pjesën e katërt në kapitullin 35 dhe 36 tregohet për *rolin dhe rendësin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rolin e trajnimit, ndërgjegjësimit dhe përmirësimit në arsim për zhvillim të qëndrueshëm*. Edhe në kapituj tjerë trajtohen roli dhe rëndësia e shumë problemeve socio-ekonomike në zhvillimin e qëndrueshëm- mbi 60% e Agende 21 ka karakter socio-ekonomik.

Kështu, Agenda 21 e cila përmban masat për “partneritet global për zhvillim të qëndrueshëm”, u shndërrua në “udhëzues dhe program të punës për shekullin 21” jo vetëm e vendeve nënshkruese të këtij dokumenti (179 vende), por edhe shumë vendeve të cilat nuk janë nënshkruese të këtij

⁵ Carter, Neil (2004). Strategjije zastite okolis, Zagreb. fq 2015

dokumenti, jo vetëm në sferën e mjedisit por edhe në shumë sfera tjera të jetës duke u inkorporuar në shumë dokumente dhe iniciativa tjera të karakterit global.

Ne funksion të avancimit të obligimeve nga Konferencës për Mjedis dhe Zhvillim (1992) dhe Konferenca e V Botërore mbi Popullsinë (1994), nga të cilat u bë thirrje për një ndryshim në drejtim të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm si dhe zgjidhjen e politikave të duhura krahas ndryshimeve demografike. Mbështetur në konkluzionet e këtyre dy konferencave dhe avancimit të zhvillimit të qëndrueshëm në vitin 2000, OKB përgatiten Objektivat e Zhvillim të Mijëvjeçarit (OMZH) me tetë qëllime baze të cilat duhet të përmbusheshin deri në vitin 2015. Në Johaneshburg në vitin 2002, organizohet Samiti Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm organizimi i pare me qëllim parësor zhvillimi e qëndrueshëm, ku theksi vihet në zgjidhjen e problemeve specifike në përputhje me OZHM. Duke e konsideruar arsimin si sektor kritik për zhvillimin e qëndrueshëm, në bashkëpunim me OZHM periudha 2005-2014 u shpall si “Dekada e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm”.

Kontribut të rëndësishëm në studimin e marrëdhënieve në mes popullsisë dhe mjedisit drejt zhvillimit të qëndrueshëm paraqet edhe takimi i Instituti Ndërkombëtar për Analizën e Sistemit të Aplikimit (IIASA) me seli në Vjenë i vitit 2011. Ekspert të fushave të ndryshme diskutuan për ndikimin dhe koordinimin e faktorëve demografike në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në takim u miratua “Deklarata e Laxenburgut mbi Popullsinë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm”, në të cilën theksohet rëndësia e sfidave demografike në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm përmes numrit, shpërndarjes dhe karakteristikave themelore të strukturave të popullsisë posaçërisht struktura e moshës e arsimore dhe si të tilla duhet të jene në thelbin e secilit zhvillim të qëndrueshëm sektorial.

Njëzet vjet pas Rios, 2012 u mbajt konferenca e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm nga ku doli propozimi ideja e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, ndërsa në vitin 2013, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së filloj identifikimin e objektivave specifike për zhvillim të qëndrueshëm. Në fund të vitin 2015 të gjitha vendet e OKB-së, miratuan programin “Ta transformojmë botën: Programi për zhvillim të qëndrueshëm, Agjendën 2030 ku përfshihen 17 objektiva, 169 tregues dhe 232 indikatorë për Zhvillim të Qëndrueshëm, ku faktorët demografik janë të pakalueshëm në qëllimet për një bote të qëndrueshme në viti 2030. Sikur edhe në Agjendën 21 edhe Agjenda 2030 preokupimin kryesor i ka njerëzit- popullsinë dhe për njerëzit- popullsinë, duke bere përpjekje që të gjitha qeniet njerëzore mund të përmbushin potencialin e tyre .

Agjenda 2030- është një plan veprimi i hartuar për përmirësimin e mirëqenies se: njerëzve, planetit dhe prosperitetit. Ideja dhe qëllimi kryesorë i agjendës mbetet zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj, përfshirë edhe varfërinë ekstreme etj., miratuar nga liderët botëror në Samitin e New Yorkut 2015 e cila filloj te zbatohet nga 1 janar 2016. Agjenda përmban 17 objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe 169 qëllime te ndërlidhura me 230 indikatorë te cilat duhet të zbatohen deri në fund të 2030.

Edhe pse ligjërisht jo të detyrueshme, qeveritë duhet të marrin përgjegjësi dhe të ndërtojnë korniza kombëtare për arritjen e objektivave. Kështu, zhdukja e varfërisë, mbrojtja e planetit dhe sigurimi i prosperitetit të popullsisë në planet është sot një nga sfidat më të mëdha globale, dhe kusht i

domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm. Nga marrëdhëniet e ngushta në mes popullsisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm mund të përfundohet se zhvillimi i qëndrueshëm në të ardhmen mund të arrihet vetëm nëse trajtohen edhe ndryshimet demografike, duke i shndërruar proceset demografike në domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm.

2. ZHVILLIMI I QENDRUESHEM DEMOGRAFIK- SUSTENDEMO

*“njerëzit janë shqetësimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm”
principi i parë i “Agende 21”*


Ndër elementet më të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm janë trendët dhe faktorët demografik, prandaj si të tillë duhet të inkorporohen në analizën globale të çështjeve të mjedisit dhe zhvillimit duke i hulumtuar bashkëveprimin midis tendencave demografike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha nivelet: lokal, kombëtar e global. Kështu për zbatimin teorik dhe praktikën të zhvillimit të qëndrueshëm në tri nivelet e lartcekura është i domosdoshëm bashkëpunimi i eksperteve të fushave të ndryshme që nënkupton qasja multidisciplinare për zhvillim të qëndrueshëm.

Në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm pa dyshim është njeriu- popullsia e shprehur kjo edhe në dokumentin më të rëndësishëm të konceptit bashkëkohor të zhvillimit të qëndrueshëm që është Deklarata e Rios 1992, respektivisht Agende 21. Një pjesë e rëndësishme (kapitulli V) e Agende 21 i kushtohet rolit dhe rëndësisë së dinamikës demografike dhe qëndrueshmërisë së saj për zhvillimin e qëndrueshëm. Për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen është e domosdoshme që:

- a) faktorët dhe trendët demografike të inkorporohen në analizën globale të mjedisit dhe zhvillimit;
- b) harmonizim sa më i mirë në mes dimensionit demografik dhe zhvillimit teknologjik, modelit kulturor të sjelljes, mjedisit, resurseve natyrore dhe përmirësimit të kushteve jetësore si dhe
- c) vlerësimin e ndjeshmërisë së njerëzve në zonat e ndotjes ekologjike sidomos në qendrat e mëdha popullore në mënyrë që të përcaktohen prioritetet për aksion në të gjitha nivelet duke i kushtuar vëmendje të plotë nevojave të komunitetit.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësin e lëvizjeve demografike për zhvillimin e qëndrueshëm dhe fakti që popullsia është strukturë biologjike e shoqërisë dhe ekonomisë e të gjitha hapësirave gjeografike, qëndrueshmëria demografike duhet të konsiderohet si nënsistem në sistemin e qëndrueshmërisë ⁶- SUSTENDEMO.

⁶ Lutz W. et al (2002), Population and environment, Population Council, New York, fq 6.



Grafiku 3. Skema e zhvillimit të qëndrueshëm demografik- Sustendemo

Megjithatë, edhe zhvillimi i qëndrueshëm demografik shpesh here konceptohet në mënyrë shumë të reduktuar, vetëm në rritjen e popullsisë dhe strukturën gjinore dhe moshove të popullsisë. Nisur nga kjo qasje autor të ndryshëm zhvillimin e qëndrueshëm demografik e definojnë me gjendjen e popullsisë e cila siguron të paktën riprodhimin të thjeshtë të popullsisë ose “rritjen optimale të popullsisë” e cila i përgjigjet nivelit të fertilitetit prej 2.1 fëmijë për grua (riprodhimi me kontingjent të njëjtë me gjeneratën paraprake). Autor të tjerë zhvillimin e qëndrueshëm demografik e konceptojnë si raport në mes popullsisë aktive (produktive) dhe asaj jo aktive (jo produktive) apo edhe si baraspeshë numerike në përfaqësimin gjinor. Pra në përpjekje për zhvillim sa më të qëndrueshëm duhet të kihet parasysh edhe komponentët demografikë të popullsisë duke përfshirë: numrin e përgjithshëm, vendndodhjen e tyre, strukturat e popullsisë si dhe ambiciet, mundësit dhe kushtet e jetës. (UNFPA, 2011).


Definicioni me gjithëpërfshirës dhe i kompletuar është definicioni i autorëve të cilët theksojnë se në definicionin e zhvillimit të qëndrueshëm demografik duhet të përfshihen edhe karakteristikat socio-ekonomike të popullsisë⁷.

Bazuar në këtë definicion modeli SUSTENDEMO, përbehet nga dy dimensione të rëndësishme të njëjtë që janë dimensionin kuantitativ dhe kualitativ.

⁷ Lutz W. et al (2002), Population and environment, Population Council, New York, fq 6.

Dimensionin kuantitativ e përbëjnë komponentët e shtimit natyrorë dhe migrimet, rritja e përgjithshme e popullsisë dhe struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Nga ky këndvështrim një territor i caktuar konsiderohet i qëndrueshëm në aspekt demografik nëse në mes madhësisë të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe strukturës së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, ekziston marrëdhënie optimale.

Dimensionin kualitativ e përbëjnë karakteristikat socio- ekonomike të popullsisë duke përfshirë në radhë të parë strukturën arsimore (edukimi) të popullsisë, përgatitjen profesionale dhe aktiviteti ekonomik.



Grafiku 4. Nënsistemet e qëndrueshmërisë demografike⁸

Për zhvillim të qëndrueshëm demografik të një zone të caktuar është e nevojshme zhvillim demografik minimale (që i përgjigjet të paktën riprodhimin të thjeshtë - tipit stacionar të popullsisë S.B) në aspekt kuantitativ (sasior) dhe kualitativ (cilësor), me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë ekonomike dhe shoqërore. Nga dimensionin kuantitativ një territor konsiderohet i qëndrueshëm në aspekt demografik kur ekziston korrelacion optimal në mes: rritjes, madhësisë, migrimeve dhe strukturës së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, ndërsa në aspekt kualitativ një territor konsiderohet i qëndrueshëm në aspekt demografik kur ekziston baraspeshë në strukturat socio- ekonomike të popullsisë⁹.

Siç shihet komponentët e dimensionit kuantitativ kanë ndikim në komponentët e dimensionit kualitativ dhe anasjelltas. Kështu të dy dimensionet të cilat e përbëjnë sistemin e qëndrueshëm

⁸ Roca Z, Roca M.N.O. Demografiska odrzivost i prostorni razvoj u Portugalu. Acta geographica Bosniae et Herzegovinae, 2014,2, fq.25.

⁹ Roca Z, Roca M.N.O. Demografiska odrzivost i prostorni razvoj u Portugalu. Acta geographica Bosniae et Herzegovinae, 2014,2, fq.25.

demografik janë në lidhshmëri të ngushtë me njëra tjetrën. Lëvizjet negative demografike në shumicën e vendeve të zhvilluara (sidomos në Evropë) dhe atyre në zhvillim u manifestuan me zhvillime negative edhe në sferat tjera si në atë sociale, ekonomike, demografike, politike e teknologjike.

Ndër problemet më të mëdha demografike të shumë vendeve të botës janë depopullimi dhe moshnimi demografik. Për shkak të dimensionit të gjerë dhe shpejtësisë së përhapjes të moshnimit, shekulli 21 do të jetë shekull i të moshuarve me tendenca intensive të moshnimit, i cili si proces deri me sot nuk është shënuar në historinë e njerëzimit, prandaj nga shumë ekspert të fushës së demografisë *shek. XXI është shpallur shekull i plakjes së popullsisë*.

Për pasoj edhe prognozat e Kombeve të Bashkuara të fund shekullit të kaluara për trendet e popullsisë globale në fillimin e shekullit XXI janë reviduar dhe korrektuar në të gjithë skenarët, pasi që siç theksojnë Bricker dhe Ibbitson. "*Ne nuk po përballemi me sfidën e një bombe të popullatës, por të zvogëlimit të popullatës njerëzore*"¹⁰.

3. PROCESIVE DEMOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI I QENDRUESHËM

3.1 A janë ndryshimet demografike çelës i zhvillimit të qëndrueshëm

Njerëzit janë shqetësimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm (Deklaratës së Rios, 1992, Parimi 1). Në përpjekje për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm duhet të marrë parasysh edhe lëvizjet demografike)- numri, vendndodhjen, struktura sipas moshës, strukturat tjera posaçërisht ajo arsimore, kushtet e jetës, ambiciet dhe mundësitë etj. (IIASA dhe UNFPA, 2011). Lëvizjet demografike janë thelbësore për të kuptuar më mirë lidhjet mes zhvillimit social, ekonomike dhe mjedisore, për një integrim të fortë dhe më kuptimplotë e këtyre dimensioneve të zhvillimi i qëndrueshëm.

Autor të ndryshëm zhvillimin e qëndrueshëm demografike e definojnë me gjendjen e popullsisë e cila siguron të paktën riprodhimin të thjeshtë të popullsisë ose "ritjen optimale të popullsisë" e cila i përgjigjet nivelit të fertilitetit prej 2.1 fëmijë për grua (riprodhimi me kontingjent të njëjtë me gjeneratën paraprake).

Definicioni me gjithëpërfshirës dhe i kompletuar është definicioni i autorëve të cilët theksojnë se në definicionin e zhvillimit të qëndrueshëm demografik duhet të përfshihen edhe karakteristikat socio-ekonomike të popullsisë.

Banka Botërore duke u bazuar në definicionin më të përhapur të zhvillimit të qëndrueshëm (Komisionit Bruntland), zhvillimin e qëndrueshëm e definojnë si: *zhvillimi i cili përfshin kalimin e një rezerve të barabartë apo sipas mundësive më të mëdha të kapitalit njerëzor, ekonomik dhe social, tek brezat e*

¹⁰Jadranka Polović: Demografski izazovi I buducnost covjecanstva", Marr nga: <https://www.geopolitika.news/analize/dr-sc-jadranka-polovic-demografski-izazovi-i-buducnost-covjecanstva/>


*ardhshëm*¹¹. Bazuar ne definicionet e larte shënuara mund të konstatohet se për zhvillim të qëndrueshëm të vendeve ose regjioneve është e domosdoshme zhvillimi i qëndrueshëm demografik i cili minimalisht kërkon që çdo vend duhet të arrij një modeli stacionar të popullsisë që nënkupton që gjenerata e ardhshme të jetë e njëjtë me atë ekzistuese. Me këtë rast është e rëndësishme studimi i te kaluarës, te tashmes dhe potencialin e ardhshëm te popullsisë se përgjithshme dhe strukturave te saj te cilat paraqesin bazën për përcaktimin e zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Me qëllim te arritjes te minimumit te nevojshëm dhe arritjes së zhvillimit demografik i cili nuk do te jete faktorë kufizues për zhvillim të qëndrueshëm është e nevojshme përmbushja e disa objektiva në zhvillimet demografike të cilat janë:

Numrin e përgjithshëm i popullsisë - me qëllim të arritjes së tipit stacionar të popullsisë ku gjenerata e ardhshme të jetë e njëjtë me atë ekzistuese ose nivel i rigjenerimit të thjeshtë të popullsisë ose zëvendësimi i brezave do të thotë që në nivelin individual një grua në periudhën e saj te pjellorisë duhet të zëvendësohet nga një fëmijë femër - shkalla neto e riprodhimit është e barabartë me një, ose nivelit të fertilitetit të përgjithshëm është 2.1 fëmijë për grua (riprodhimi me kontingjent të njëjtë me gjeneratën paraprake).

3.2. Struktura e popullsisë sipas moshës

Struktura e popullsisë sipas moshës tregon jo vetëm të kaluarën por edhe të tashmen dhe të ardhmen e zhvillimit demografik. Në të njëjtën kohë është treguesve më i rëndësishëm demografik i cili përveç në zhvillimin e popullsisë ndikon edhe në të gjitha sferat tjera socio-ekonomike, prandaj analiza e strukturës së popullsisë sipas moshës është bazë jo vetëm në kërkimet demografike por edhe për të gjitha sferat tjera socio- ekonomike duke e shndërruar procesin në faktor të rëndësishëm për zhvillim te qëndrueshëm socio-ekonomik dhe hapësinor ne përgjithësi.

Grafiku 5. Modeli i piramidës se popullsisë së tipit stacionar te popullsisë



Një territor konsiderohet i qëndrueshëm në aspekt demografik (sa i përket strukturës së popullsisë sipas moshës), kur ekziston korrelacion optimal në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë (grafiku 5).

¹¹ Banka Botërore, Shqipëria: rruga drejt një zhvillimi të qëndrueshëm., Marr nga; www.bankofalbania.org/web/pub/sybi_hida_280_1.pdf.

3.3. Moshimi demografik

Agjenda 2030, paraqet plan universal veprimi drejt zhvillimit të qëndrueshëm në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të të gjithë njerëzve duke mos anashkaluar askënd dhe asnjë grup të shoqërisë duke përfshirë të gjitha segmentet e shoqërisë, të gjitha moshat, me një fokus të veçantë në grupet më të ndjeshme siç janë personat e moshuar.

Fakti që shekulli XXI do të jetë shekull i moshimit, çelësi i ballafaqimit me këtë proces është fakti se si të shfrytëzohen mundësitë që ofrojnë këto grupmosha (përvoja dhe aftësi të pakrahasueshme, pjesëmarrjen aktive të brezave të vjetër në ekonomi, tregun e punës dhe shoqërinë në përgjithësi etj.), të përballen me sfidat që sjell procesi, t'i përgjigjen plakjes së popullatës dhe të promovojnë një zhvillim të qëndrueshëm të moshimit.

Me rritjen e pjesëmarrjes të moshuarve në popullsinë e përgjithshme të një vendi shoqëria duhet të rris njohuri për rendësin, nevojat, të drejtat e personave të moshuar, me qëllim të eliminimit të paragjykimeve dhe diskriminimit ndaj personave të moshuar. Kjo arrihet duke pasqyruar e promovuar kontributet e këtyre grup moshave në shoqëri në vend të përqendrimit të efektet dhe anët negative të moshimit demografik. Në këtë mënyrë do të përmbushët qëllimi kryesor i Agjendës 2030, për gjithëpërfshirës dhe mos anashkalim të askujt.

3.4. Migrimet e popullsisë

Në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit çështje e migracionit nuk ishin adresuar komfor rëndësisë së tyre në përmbushjen e objektivave, ndërsa me Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm të vitit 2030, migrimet marrin vëmendje të veçantë në përmbushjen e kësaj agjende dhe kërkohet qasje ndërdisiplinore dhe angazhim shumëdimensional dhe gjithëpërfshirës në trajtimin e rolit dhe rëndësisë së migrameve me qëllim të përmbushjes së objektivave të Agjendës 2030.

Migrimi e popullsisë paraqesin potencial të konsiderueshëm për të larguar miliona njerëz nga varfëria duke siguruar punësim më të madh dhe qasje në punë të dinjitetshme duke ndikuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm. Migrimet e popullsisë sidomos ato të pa organizuara dhe kontrolluara mund të kenë efekte negative duke favorizuar trafikimin njerëzor, shfrytëzimin e migrantëve, ikjen e trurit, rritjen e varësisë nga dërgesat¹² etj..

Ndërlidhja e ngushtë që ekziston në mes migrameve e zhvillimit (si në vendin e origjinës ashtu edhe vendin e destinacionit) dhe peshës së migrameve për arritjen e OZHQ i bëjë migrimet pjesë integrale të Agjendës 2030¹³. Në realitet migracioni është i rëndësishme për 10 (objektiva 1,3,4,5,8,10,11,13,16 dhe 17) nga 17 OZHQ dhe shumicën e 169 synimeve të Agjendës që tregojnë për rolin dhe rendësin e migrameve në përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030. Agjenda

¹² McGregor, E. (2016). Intergovernmental Organizations, Migration and the Sustainable Development Goals. *Migrating out of Poverty*, 2-26.

¹³ Schraven, D. B., Keijzer, N., & Knoll, A. (2013). Post 2015: Making Migration Work for Sustainable Development. (Proucavje Migracije Stanovnistva u Skladu sa Ciljevima Odrzivog Razvoja Ujedinjenih Nacija)

specifikisht ne objektiven 10.7, kërkon: lehtësimin e migrimeve, migracion të sigurt, të rregullta dhe të përgjegjshëm", zbatimin dhe menaxhim të mire të "politikave të migrimit" etj.

Prandaj, për arritjen e OZHQ duhet të ketë kontroll të migrimeve që ato të jen të rregullta, të sigurt dhe të përgjegjshme, të mos shndërrohen në problem demografi, socio- ekonomik dhe të sigurisë ***siç janë zhvillimet e tanishme në Kosovë***, ku emigrimet janë shndërruar në kontribuuesin kryesor në disavantazhet e tendencave demografike dhe socio-ekonomike. Prandaj është e domosdoshme krijimi i modelit të qëndrueshëm të migrimeve.

3.5. Urbanizimi

Urbanizimi është proces historik, kompleks dhe botëror i cili zhvillohet krahas me zhvillimin dhe ndryshimet e përgjithshëm shoqëror-ekonomik. Si proces kompleks urbanizimi është objekt i studimit shumë disiplinave shkencore prandaj edhe definicioni i tij varet nga aspekti i qasjes. Kështu nga aspekti demografik urbanizimi nënkuptohet si procesi i koncentrimit të popullsisë në qytete (zona urbane), nga aspekti urban fjala është për koncentrimin të funksioneve në një vendbanim, ekonomistet me urbanizëm nënkupton koncentrimin e fuqisë prodhuese në industri dhe veprimtaritë posindustriale, kurse nga aspekti sociologjik urbanizimi është proces i nivelit të zhvillimit shoqëror i cili përcjellët me ndryshime në mënyrën e jetës.

Organizatet e specializuara të Kombeve të Bashkuara specifikojnë se Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 17 objektivat e saj mund të zbatohen dhe arrihen me sukses vetëm nëse vendet fillojnë një tranzicion drejt një urbanizimi të qëndrueshëm. Domosdoshmërinë për urbanizëm të qëndrueshëm rrjedh nga një fakt demografik se deri në funde të gjysmës së parë të shek. XXI, mbi 65 % e popullsisë botërore do të jetojnë në qytete dhe qyteza.

Zhvillimi i qëndrueshëm urban është i lidhur ekskluzivisht me objektiven 11 të Axhendës 2030, Qytetet dhe komunitete të qëndrueshme që nënkupton qytetet si: vendbanime gjithëpërfshirës, të sigurt, të qëndrueshëm etj. Në fakt, zhvillimi i qëndrueshëm i qytete është thelbësor për 11 nga 17 objektivat e Axhendës 2030, si për shembull:

- Qytetet kanë një rol të rëndësishëm në 'dhënien fund të varfërisë'(objektiva 1);
- 'Zvogëlimi i pabarazisë' (objektiva 10);
- promovimin e rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të punësimit dhe produktivitetit (objektiva 8);
- veprime urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimit të tyre (objektiva 13)¹⁴ etj.

Me qëllim të adresimit të plotë dhe gjithëpërfshirës të rolit të urbanizimit në zhvillimin e qëndrueshëm Kombet e Bashkuara në vitin 2016, organizuan konferencën mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban dhe Strehimin (Habitat-III), konkluzionet dhe synimet e të cilës do të kthehen në një Agjendë të Re Urbane për veprim, e cila do të përcaktojë një qasje globale ndaj urbanizimi për 20 vitet e ardhshme.

¹⁴Sustainable urbanization strategy UNDP 's support to sustainable, inclusive and resilient cities in the developing world, UNDP, New York, 2016, fq 6.. file:///C:/Users/sami/Downloads/UNDP_Urban-Strategy.pdf

Agjenda e Re Urbane përfaqëson një vizion të përbashkët për një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme të zhvillimit urban i cili nëse planifikohet dhe menaxhohet mirë mund të shndërrohet në një proces të fuqishëm për zhvillim të qëndrueshëm si për vendet në zhvillim ashtu edhe për vendet e zhvilluara.

Ne kuadër të rrugëve për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmbushje të Agjendës 2030, ndër elementet më të rëndësishme sipas eksperteve të UNFPA është integrimi i projeksioneve të popullsisë në strategjitë dhe politikat zhvillimore¹⁵, duke spikatur edhe një here rolin, rendësin dhe domosdoshmërinë e zhvillimeve demografike për zhvillim të qëndrueshëm.

Duke pasur parasysh dy dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm demografik dhe rëndësisë së integritimeve të projeksioneve të popullsisë në strategjitë dhe politikat zhvillimore në vazhdim do të paraqiten trendët e komponentëve kuantitative dhe kualitative në Kosove për të konstatuar qëndrueshmërinë e këtyre komponentëve në vitet në vazhdim në Kosove dhe të konstatohet qëndrueshmëria e tyre si faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm në përgjithësi.

Trendet dhe perspektiva në rritjen e popullsisë, moshnimi demografik- plakja e popullsisë, migracioni dhe urbanizimi paraqesin mundësi dhe sfidën kryesore të vendeve drejt Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe përmbushje të Agjendës 2030, me implikime direkte dhe indirekte¹⁶. Në vazhdim do të paraqiten trendët dhe perspektiva e këtyre parametrave demografik në Kosove dhe do të behet përpjekje për përcaktimin e këtyre trendëve në përmbushjen e Agjendës 2030 dhe Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në rastin e Kosovës.

¹⁵ Development, Co-operation Report 2012. Lessons in Linking Sustainability and Development. Marr nga: <http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/4312011ec011.pdf?expires=1475241543&id=id&accname=guest&checksum=164431C2E94103DDF8FE25565CD9E189>.

¹⁶ Population Dynamics in the Post-2015 Development Agenda: Report of the Global Thematic Consultation on Population Dynamics, UNFPA, UNDESA, UN-HABITAT, IOM 2013, Marr nga: <https://www.iom.int/files/live/sites/iom/files/What-We-Do/docs/Outcome-Report-Pop-dynamic-and-post-2015-dev-agenda-14-March-2013.pdf>

4. PERSPEKTIVA E PROCESVEVE DEMOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI I QENDRUESHËM- RASTI I KOSOVËS

Në zhvillimit të së tashmes dhe të ardhmes faktorët demografik (dinamika demografike) është element i rëndësishëm në përcaktimin e drejtimit të zhvillimit socio-ekonomik të një vendi e me këtë rast edhe për qëndrueshmërinë në zhvillimin e përgjithshme. Dinamika e popullsisë me strukturat e saj dhe karakteristikat cilësore dhe sasiore duhet të jenë pika fillestare në analizën e sfidave dhe mundësive drejt zhvillimit të qëndrueshëm duke përfshirë këtu edhe ndikimin e karakteristikave të ndryshme të popullsisë në mjedis.

Banka Botërore duke u bazuar në definicionin më të përhapur të zhvillimit të qëndrueshëm (Komisionit Brundtland) dhe Deklaratën e Stokholmit në të drejtat e gjeneratave të tretë dhe të drejtën në barazi dhe *qëndrueshmëri të gjeneratave*, zhvillimin e qëndrueshëm e definon si: *zhvillimi i cili përfaqëson kalimin e një rezerve të barabartë apo sipas mundësive më të mëdha të kapitalit njerëzor, ekonomik dhe social, tek brezat e ardhshëm*¹⁷, duke i dhënë kështu zhvillimit të qëndrueshëm një dimension tjetër të rëndësishëm që është dimensionin demografik.

Duke u bazuar në të gjitha definicionet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në zhvillimin qëndrueshëm demografik-SUSTENDEMO i cili përbehet nga dimensionin kuantitativ dhe kualitativ kemi shqyrtuar perspektivën demografike dhe socio-ekonomike të popullsisë së Kosovës duke u bazuar në parashikimet e popullsisë 2011-2061 për të konstatuar se sa të qëndrueshme do të jenë këto zhvillime.

Lëvizjet e lindshmërisë e sidomos e emigrimeve mund të konsiderohen shqetësuese të cilat kanë dhe do të kenë ndikim dhe efektet negative në shumë sfera të jetës duke përfshirë këtu edhe sferën demografike, socio-ekonomike, arsimore etj., edhe në të ardhmen. Periudha 1990- 1999, në Kosovë karakterizohet me zhvillime negative në të gjitha sferat e jetës duke përfshirë edhe sferën demografike, e përcjell kjo me emigrime masive të cilat fatkeqësisht vazhduan edhe pas luftës së vitit 1999, të cilat u manifestuan me rrënie në nivelin e lindshmërisë, ndryshime në strukturat e popullsisë (sipas gjinisë, moshës, strukturën arsimor etj.), kurorëzime, shkukurëzime etj., Rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 treguan të gjitha anët negative të zhvillimeve politike, sociale dhe ekonomike të dekadës së fundit të shek. XX në sferën demografike të cilat pa dyshim se do të përcjellën me pasoja negative në sferat tjera të jetës.

Sipas Parashikimit të Popullsisë së Kosovës 2011-2061, Kosova në të ardhmen do të ballafaqohet me sfida edhe më serioze për shkak të tendencave të pavolitshme demografike të cilat në radhë të parë (sot) kanë goditur zonat kodrinore – malor, ndërsa në të ardhmen pritet të zgjerohen me zgjerimin e procesit të depopullimit.

Kjo për faktin se pa marr parasysh se për cilin sektor socio-ekonomik apo mjedisor është fjala, rruga për zhvillim të qëndrueshëm janë njerëzit kështu që është e domosdoshme që problemet dhe potenciali demografik të merret në konsideratë nëse dëshirojmë të gjejmë përgjigjeje në

¹⁷ Banka Botërore, Shqipëria: rruga drejt një zhvillimi të qëndrueshëm., Marr nga; www.bankofalbania.org/web/pub/sybi_hida_280_1.pdf.

kërkesën për qëndrueshmëri në zhvillimin ekonomik, shoqërore, ekologjik dhe përmbushje të Agjendës 2030.

Variablat e përzgjedhura për të prezantuar dimensionin sasior të qëndrueshmërisë demografike në rastin e Kosovës në gjysmën e par të shek. XXI, janë: lëvizja e numrit të përgjithshme- rritja natyrore, struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë- moshimi demografik, migracioni dhe shpërndarja hapësinore e popullsisë- urbanizimi.

Ndërsa, variablat socio-ekonomike që do të trajtohen në varësi të atyre demografike janë: struktura arsimore, struktura ekonomike me elementet e tyre të cilat varen drejtpërdrejt nga zhvillimet demografike dhe do të konstatohet se sa të qëndrueshme do të jene këto zhvillime në periudhën e cekur në Kosove dhe hapat që duhet ndërmerru me qellim të arritjes të një zhvillimi të qëndrueshëm demografik si imperativ i kohës drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

4.1. Perspektiva demografike dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Në zhvillimin dhe krijimit të së tashmes dhe të të ardhmes faktorët demografik (dinamika demografike) është element i rëndësishëm në përcaktimin e drejtimit të zhvillimi socio-ekonomi të një vendi e me këtë rast edhe për qëndrueshmërinë e përgjithshme.

4.1.1. Zhvillimi demografik i Kosovës

Kosova karakterizohet me zhvillim specifik demografik në krahasim me vendet tjera të rajonit por edhe të Evropës në përgjithësi. Një zhvillim i tillë ishte në radhë të parë si pasoj e nivelit të ulët dhe vonë të industrializimit, urbanizimit të jetës si dhe strukturës ekonomike shumë të njëanshme me bazë industrinë ekstraktive. Kështu Kosova u vonua në fazat e tranzicionit demografik duke paraqitur transicionin e fundit demografik në Evropë.

Dekada e fundit e shek. XX, karakterizohet me zhvillime negative në të gjitha sferat e jetës: ekonomike, shoqërore dhe politike në Kosovë, e cila u manifestua me impakte negative edhe në sferën demografike. Është kjo periudhë e emigrimeve masive të popullsisë (popullsi e hapur) sidomos e asaj të aftë për riprodhim e cila u manifestua me rënien e shkallës së lindshmërisë dhe shtimit natyror, rënien e normës së kurorëzimeve, çrregullime ne strukturat tjera të popullsisë si dhe pasojat tjera nga lufta e fund shekullit, të cilat u dokumentuan edhe me regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.

Kriza e viteve të '90 të shekullit të kaluar u manifestua me zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë -9.1%, rënie të lindshmërisë nga 30.5‰ (1988) në 19.2‰ (2011), shtimit natyror nga 24.9‰ në 15.1‰, ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës me zvogëlimin e pjesëmarrjes së grup moshave të reja dhe rritjen e pjesëmarrjes së atyre të moshuara etj.

Lindshmëria	Shtimi Natyror	Kurorëzimet	Shkurorëzimet
-------------	----------------	-------------	---------------

1990	55175	46961	12742	509
2000	42920	34296	11866	396
2011	27623	20512	17343	1469
2018	22870	13870	18332	-
1990/2018	-141.3% (2.4 here)	- 238.6% (3.4 here)	30.5%	65.4%

Tabela 1. Lindsshmëria, shtimi natyror, kurorëzimet dhe shkuroreëzimet në Kosovë 1990-2018

Faktorët kryesor me ndikim në rënjen e përshpejtuar të natalitetit dhe shtimit natyror në Kosove janë:


- a) emigrimi i grup moshave të reja të popullsisë, posaçërisht në tre dhjetëvjetëshat e fundit;
- b) humbjet e resurseve njerëzore gjatë luftërave;
- c) struktura e pavolitshme ekonomike dhe përkeqësimi i situatës ekonomike dhe politike nga vitet e '90, të shekullit XX;
- d) mungesa e politikave zhvillimore të cilat do të ishin në funksion të de motivimit të të rinjve për emigrim.
- e) krijimi i kushteve për njerëzit e sidomos për rinin që të kenë besim në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre i cili është çelës për ndalimin e krizës demografike duke ulur fluksin e emigrimeve etj

Studimet të shumta tregojnë se nëse popullsia veçanërisht të rinjtë kane qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor cilësor, nëse janë në punësim të qëndrueshëm dhe marrin mbështetje për rritjen e fëmijëve, ata kane më pak gjasa të emigrojnë dhe kanë me shume gjasa të vendosin të kenë fëmijë.

4.1.2. Dinamika në numrin e përgjithshëm të popullsisë

Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës tregon se sa here që Kosova kaloi nëpër faza të qeta të zhvillimit kishte rritje të popullsisë, ndërsa në periudha krizash politike, ekonomike e luftërave ka shënuar rënie të popullsisë me humbje njerëzish ose emigrim.

Pas Luftës së Dytë Botërore me përmirësimi i kushteve socio-ekonomike dhe sanitare numri i përgjithshëm i popullsisë ka ardhur vazhdimisht duke u rritur (deri në fillim të shek. XXI), edhe pse emigrimet vazhduan me intensitet të ndryshëm gjatë gjithë periudhës për të arritur kulminacionin në 10 vjetshin e fundit të shek XX, kur vlerësohet se emigruan 30-35% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Si pasoj e emigrimeve masive dhe humbjeve në luftën e vitit 1999, popullsia e Kosovës për herë të parë në periudhën 1991-2011 karakterizohet me tendencë të zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të popullsisë për -9.1%.



Grafiku 6. Dinamika në numrin e përgjithshëm të popullsisë 1948-2061

Kosova sot ndodhet para ndryshimeve radikale në profilin e saj demografik. Këtë më së miri e argumenton faktet se: në njërin anë kemi zvogëlim drastik të numrit të lindjeve dhe shtimit natyror ndërsa në anën tjetër si pasojë e emigrimeve selektive, popullsia po plaket me trendë të përshpejtuara. Situata është aq e pafavorshme sa që mund të përcaktohet edhe si krizë demografike. Shkaqet janë shumë komplekse, unike dhe janë një reflektim dhe funksion gjithnjë në rritje i thellimit të krizës shoqërore, ekonomike, sociale dhe vlerës / identitetit e manifestuar kjo në shumë segmente të jetës socio-ekonomike duke përfshirë edhe sistemin arsimorë.

Treguesit demografik në Kosovë 2000- 2020

Numri i përgjithshëm i popullsisë- karakterizohet me trend të përsheptuar të rënies. Në raport me vitin 2000 kur Kosova llogaritet të kishte 2.370.000 (vlerësim meqenëse nuk kishte regjistrim të popullsisë) banor, në fund të 2019 numri i banorëve u zvogëluar në 1.782.115, ose zvogëlim për -587.885 banorë, ose -24.8%. Kosova në këtë periudhë ka humbur ¼ e popullsisë.

Trendët e lindshmërisë- në vitin 2019, në Kosovë është regjistruar numri më i vogël i lindjeve që nga viti 1920 respektivisht 1939. Numri i të lindurve në Kosovë në periudhën 2000-2020 është zvogëluar nga 38.687 (2000, lindjet vetëm në Kosovë), në 21.798 (2019), që nënkupton rënie për 16.889 lindje ose gat përgjysmim të lindjeve (-43.6%).

Trendët e vdekshmërisë- vdekshmëria është e vetmja komponent e lëvizjes natyrore të popullsisë që në periudhën e vështruar karakterizohet me trendë të rritjes. Kështu në raport me vitin 2000 kur kishte 8624 vdekje në vitin 2019 numri arrin në 10.501 vdekje, që tregon rritje prej 21.8%.

Shtimi Natyror- karakterizohet me tendin edhe me të shpejt të rënies se sa edhe lindshmëria. Kështu , në raport me vitin 2000 kur shtimi natyror ishte 34.296 persona në vitin 2019 zvogëlohet në 15.294, që paraqet zvogëlim për 19.002 persona, ose më tepër se përgjysmim (-55.4%). Shtimi natyror në vitin 2019 është i përafërt me atë të gjysmës së dytë të viteve të '30 të shekullit të kaluar.

Kurorëzimet- gjatë periudhës 2002-2019 kanë treguar trendin të zvogëlimit. Përderisa në vitin 2002, Kosova ka regjistruar 18.280 kurorëzime, në vitin 2018 ky numër bie në 16.871 që tregon një rënie prej 1.409 ose për -7.7 %.

Shkurorëzimet- gjatë periudhës 2000-2019 kanë treguar trendin më të shpejt të rritjes. Përderisa në vitin 2000, Kosova ka regjistruar 396 shkurorëzime, në vitin 2018 numri i shkurorëzimeve arrin e mbi 1000 që tregon një rritje prej 152.3 % ose 2.5 here.

(S. Behrami: "Kriza demografike e Kosovës në dy dekadat e shek. XXI". <https://www.albinfo.ch/kriza-demografike-ne-kosoves-ne-dy-dekadat-e-shek-xxi/>).

Tabela 2. Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës: parashikimi 2011-2061

Sipas parashikimit në të cilin është bazuar punimi¹⁸, popullsia e Kosovës do të tregoj trendë të stagnimit ose rritjes shumë të ulët deri në vitin 2034, shumë më i ngadalshme se gjatë gjysmës së dytë të shek. XX si pasoj e faktorëve të lartpërmendur.

Kosova në vitin 2034 do të ketë 1935630 banorë. Kështu që për 23 vite (2011-2034) numri i banorëve do të rritet për 155.609 banor ose 8.1%. Viti 2034 paraqet vitin e kthesës kur Kosova do të fillojë të ballafaqohet me depopullimin si problem demografik i cili nga dekada në dekadë do të thellohet vazhdimisht me mesatare vjetore prej: në periudhën 2031-2041, -0.05%, 2041-2051, -0.33 dhe për përdhën 2051-2061, -0.62%.

Gjykuar sipas rezultateve të parashikimit, Kosova në vitin 2061 do të ketë numër të njëjtë të popullsisë me gjysmën e dytë të viteve të '80 të shek. XX, që do të thotë do të kthehet mbropa për 75 vjet sa i përket gjendjes së numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Viti	Nr. i popullsisë	Mesatarja vjetore e rritjes/ zvogëlimit
------	------------------	---

¹⁸ "Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061". Agjencia e Statistikave të Kosovës. Prishtinë 2013.

		Absolute	%
2011	1780021	-	-
2021	1883805	(2011-2021) 10378	0.58
2031	1931957	(2021-2031) 4815	0.25
2041	1923175	(2031-2041) – 878	- 0.05
2051	1859447	(2041-2051) – 6373	- 0.33
2061	1743470	(2051-2061) – 11598	- 0.62

Tabela 3. Perspektiva e kontingjenti fertil të popullsisë 15-49 vjeç në Kosovë 2011-2061

Pas shekullit XX kur popullsia e Kosovës shënoj rritje të popullsisë për 139.6% (1948-1991), gjysma e parë e shek. XXI- faza e parë do të karakterizohet me stagnim ose rritje të ngadalshme të popullsisë 8.5% (2011-2031), ndërsa faza e dytë (2031-2061) do të jetë fazë e procesit të depopullimit me rritje negative prej -9.8%. Deri në fund të shekullit procesi i depopullimit do të thellohet edhe më tepër kuptohet nëse nuk ndodhin zhvillime të papritura pozitive ose negative.

Rezultatet e parashikimit tregojnë se trendët demografike në Kosovë deri në vitet e '30 të shek. XXI do të jenë pozitive (për disa parametra demografik), pas të cilave Kosova do të karakterizohet me trendë të zvogëlimit të vazhdueshëm të cilat do të përcjellën me pasoja të shumta jo vetëm në sferën demografike por edhe atë socio-ekonomike.

Me qenë se burim kryesor i rritjes së popullsisë në Kosovë në të kaluarën ishte shtimi natyror atëherë të dhënat për kontingjentin e popullsisë fertile në të ardhmen janë burim i rëndësishëm për të treguar trendët e lëvizjes së popullsisë së Kosovës në të ardhmen. Sipas parashikimeve, kontingjenti fertil femëror (15-49 vjet) do të tregoj tendencë të zvogëlimit të vazhdueshëm. Kështu në raport me vitin 2011, në vitin 2031 kontingjenti fertil do të jetë më i vogël për 15268 femra, ndërsa në vitin 2061 për 161574 femra. pjesëmarrja do të zvogëlohet nga 53.7% (nga numri i përgjithshëm i femrave) në 36,5%. Kontingjenti fertil femëror gjatë periudhës 2011-2061 do të zvogëlohet për -34.1%, që pa dyshim do të përcjellët me uljen e normës së lindshmërisë.

	Regjistrimi 2011	Projeksionet		Rritje/zvogëlim	
		2031	2061	2031	2061
Kosovë	474,503	459,235	312,929	-3.2	-34.1

Studimet të shumta¹⁹ tregojnë se barrën kryesore të lindshmërisë në Kosovë e bartin grup moshat e reja të kontingjentit fertil femëror (20-29 vjet) duke reduktuar pjesëmarrjen e grup moshave të tjera më të vjetra në lindshmëri. Parashikimet për kontingjentin e ri fertil femëror janë edhe më të 'zymta' me qenë se në periudhën 2011-2061, llogaritet se ky kontingjent do të zvogëlohet për 61874 femra, ndërsa pjesëmarrja nga 16.9% (2011) në 10.2% (2061). Kështu grup moshat e reja të

¹⁹ Islami H. (2005). "Studime demografike- 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës". Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Prishtinë : Behrmi S et.al (2012). "Challenges of Live births in Kosovo in the second Half of the Twentieth Century and the Beginning of XXI century". 15th International Information Society – IS 2012 Multiconference", Facing Demographic Challenges. Volume B.,Lubjanë , Slovenia.

kontingjentit fertil femëror do të zvogëlohet për -41.5 % që është edhe një argument për trendët në rënie të lindshmërisë gjatë periudhës së dhënë.

Kosova në vitin 2011 kishte Normë Totale të Lindshmërisë 2.0 fëmijë për grua që do të thotë se NTL ishte nën mesataren e nevojshme për ripërtëritje të thjeshtë të popullsisë që është 2.1 fëmijë. Për shkak të shumë faktorëve siç janë: niveli i shkollimit të femrave, punësimit, planifikimit të familjes, shtyrjes së martesave, migrimet, gjendjes ekonomike etj., gjasat që NTL të ulet janë shumë reale në 1.7 fëmijë për grua me 2031 dhe 1.5 fëmijë për grua në 2061²⁰. Në këtë situatë postolata kryesore do të ishte: *fertiliteti dhe rritja e tij duhet të konsiderohen si pasuri ekonomike*²¹.

Faktorët socio-ekonomik të cilët ndikojnë në uljen e normës së fertilitetit sot, pa dyshim që do të vazhdojnë ndikimin edhe në të ardhmen, duke ndikuar që elementet e krizës demografike në Kosovë të thellohen nga gjysma e dekadës së dytë dhe fillimi i dekadës së tretë për të vazhduar me tende të përshpejtuara deri në fund të periudhës së parashikimit edhe në të ardhmen.

5. PERSPEKTIVA E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS MOSHËS-MOSHIMI DEMOGRAFIK

*Plakja i popullsisë është realitet në vendet të zhvilluara edhe ato në zhvillim. Shekulli XXI është shekull i plakjes së popullsisë.
(Lutz, Sanderson, Scherbov, 2004)*

Struktura e popullsisë sipas moshës tregon jo vetëm të kaluarën por edhe të tashmen dhe të ardhmen e zhvillimit demografik²². Në të njëjtën kohë është treguesve më i rëndësishëm demografik i cili përveç në zhvillimin e popullsisë ndikon edhe në të gjitha sferat tjera socio-ekonomike, prandaj analiza e strukturës së popullsisë sipas moshës është bazë jo vetëm në kërkimet demografike por edhe për të gjitha sferat tjera socio- ekonomike.

Në bazë të indikatorëve të trajtuar mund të konstatohet se për një periudhë mbi 25 vjeçare, Kosova ka një çekuilibër të theksuar ndërmjet brezave me kalimin e popullsisë në një shkallë më të lartë të plakjes demografike e ndikuar kjo në radhë të parë nga lëvizjet migruese dhe lufta e fund shekullit XX, të manifestuara negativisht në numrin e përgjithshëm, normën e lindshmërisë, strukturën e popullsisë sipas moshës e gjinisë dhe komponentët tjera të popullsisë.

Perspektiva e zhvillimit të ardhshëm e bënë të domosdoshme ndërmarrjen e masave në drejtim të vënies nën kontroll të këtij fenomeni pas që trendët në dekadat e ardhshme do të jenë shumë më të pa favorshme për zhvillimet demografike në përgjithësi dhe strukturën e popullsisë sipas moshës- moshimit demografik në veçanti. Zvogëlimi i kontingjentit të grup moshave të reja të

²⁰ “Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061”. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Prishtinë 2013. fq 25.

²¹ “Demografski razvoj Vojvodine- stanje i perspektiva”. Zbornik radova. Departamen za geografiji, turizam I hoteljerstvo, 39/2010. Novi Sad, fq 10

²² Islami H. (2005). “Studime demografike- 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës”. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Prishtinë.

popullsisë, përkeqësimi i situatës në kontingjentin e fuqisë punëtore (moshimi i fuqisë punëtore) dhe rritja e popullsisë së moshuar do të përcillen me përkeqësim dhe presion në qëndrueshmërinë demografike, sociale dhe ekonomike të Kosovës.

5.1. Moshimi demografik- definicionet dhe treguesit

Në literaturën demografike ekzistojnë disa definicione për moshimin demografik të popullsisë. Definicioni më i shpeshtë nënkupton rritjen e numrit dhe pjesëmarrjes së popullsisë së moshuar mbi 60 vjet (ose mbi 65 vjet) në numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Ndërsa si tregues të moshimit demografik përdoret ndryshimi në Koefficientin e vjetërsisë ose ndryshimi (rritja) e pjesëmarrjes së grup moshave të vjetra në popullsinë e përgjithshme. Procesi i moshimit demografik shprehet edhe përmes raportit mes grup moshave të vjetra dhe atyre të reja. Në këtë rast analizohet ndryshimi në raportet e popullsisë të grup moshave deri 14 ose 19 vjet dhe atyre të vjetra mbi 60 ose 65 vjet. Ky është Indeksi i moshimit dhe paraqet treguesin demografik i cili më së shpeshti përdoret për të treguar nivelin e moshimit demografik të popullsisë. Moshimi demografik mund të definohet edhe si proces i rritjes më të shpejtë të numrit dhe pjesëmarrjes së popullsisë së moshuar (mbi 65 vjet) në raport me popullsinë e aftë për punë- kontingjentin e punës (15-64 vjet), kur kemi të bëjmë me koefficientin e varësisë së moshës.

5.2. Moshimi demografik në Kosovë

Situata dhe proceset demografike në Kosovë janë tema të shpeshta trajtimi të fushave të ndryshme shkencore, por është shumë i vogël (për të mos thënë se mungojnë fare) numri i punimeve të cilat trajtojnë temën dhe problemin e moshimit demografik të popullsisë së Kosovës. Mungesa e hulumtimeve të moshimit demografik në Kosovë mund të vijë për faktin se Kosova krahasuar me vendet Evropiane ende nuk ballafaqohet me moshim demografik dhe pasojat e tij, siç është rasti me shumicën e vendeve evropiane.

Se sa popullsia e Evropës është përfshirë nga procesi i moshimit demografik më së miri e ilustron fakti se edhe vendet me pjesëmarrjen më të ulët të grup moshave mbi 65 vjet të cilat janë: Kosova dhe Turqia, ndodhen në proces të moshimit (në të dy vendet koefficienti i moshimit është mbi 7%). Pjesëmarrja prej 8% të grup moshave mbi 65 vjet është tregues se një popullsi është përfshirë nga moshimi demografik, ndërsa në gjendje më të rëndë sa i përket moshimit demografik ndodhen: Gjermania 20.6%, Italia 20.3%, Greqia 19.2%, Portugalia 19.1%, Suedia 18.5%, Bullgaria 18.5%, Lituania 18.4%, Letonia 17.9%, Austria 17.8%, Kroacia 17.7% etj.

Në Kosovë procesi i moshimit demografik paraqitet si fenomen nga vitet e '70 të shekullit të kaluar (periudhë kur fillon zvogëlimi i pjesëmarrjes së grup moshave të reja në popullsinë e përgjithshme). Si rezultat i normës së lartë të lindshmërisë, zvogëlimit të vdekshmërisë posaçërisht atij të foshnjave dhe fëmijëve, pjesëmarrja e popullsisë së re deri në gjysmën e viteve të '80 të shekullit të kaluar nuk ka pësuar ndryshime të mëdha dhe përbënte mbi gjysmën e popullsisë.

Ndryshime të rëndësishme (negative) në këtë aspekt ndodhin në dekadën e fundit të shekullit XX, kur për herë të parë kjo pjesëmarrje zvogëlohet nën 50%, edhe pse grup moshat e reja përbënin pjesën në të madhe të popullsisë. Duhet theksuar se edhe pse pjesëmarrja e grup moshave të reja është zvogëluar që nga vitet e '70, numri i përgjithshmen është rritur deri në fillim të viteve të '90. Situata e viteve të '90, përveç në sferën demografike dhe socio-ekonomike, negativisht u manifestua edhe në strukturën e popullsisë sipas moshës duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së grup moshave të vjetra.

Migrimet dhe situata e përkeqësuar sociale, ekonomike dhe politike e viteve të '90 të shekullit të kaluar në moshimin demografik të popullsisë së Kosovës u manifestua në dy aspekte:

- ❖ përmes migrimëve selektive të grup moshave të reja të popullsisë duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre në popullsinë e përgjithshme dhe
- ❖ migrimet e popullsisë së aftë për riprodhim duke shkaktuar rënie të normës së përgjithshme të lindshmërisë duke shkaktuar moshimin nga baza (poshtë)

Kosova i takon viseve me të cilat procesi i moshimit demografik është në fazën fillestare, që pa dyshim është favorizuese në krahasim me vendet tjera Evropiane. Pas luftës së dytë botërore, Kosova karakterizohet me rritje të numrit të përgjithshëm të grup moshave të reja deri në vitet e '80, ndërsa grup moshat e vjetra kanë treguar tendenca të rritjes nga vitet e '80, me trendë të përshpejtuara në raport me kategoritë tjera procesi cili do të vazhdoj edhe në të ardhmen. Në të njëjtën periudhën pjesëmarrja e grup moshave të reja në Kosovë, kishin tendencë të rritjes deri në vitet e '70, ndërsa pjesëmarrja e grup moshave të vjetra deri në vitet e '80 kishin tendencë të zvogëlimit prej kur fillon rritja e pjesëmarrjes në popullsinë e përgjithshme.

Rezultatet e regjistrimit të popullsisë 1981 tregojnë se popullsia e re (0-19 vjet) ishte 828271 persona ose 52.4%, ndërsa popullsia e vjetër (mbi 60 vjet) ishte 101729 persona ose 6.4%. Sipas të dhënave të lartcekura popullsia e Kosovës i takonte grupit të popullatave të reja, në të cilat kontingjenti më i madh i popullsisë e përbënin popullatat e reja.

Tabela 4. Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1948-2011-pjesëmarrja.

Vitet	Popullsia e përgjithshme.	0-19	20-39	40-59	Mbi 60	Indeksi i moshimit	Mosha mesatare
1948	727820	52.0	24.3	16.1	7.6	0.15	25.3
1953	815908	50.8	25.8	15.8	7.6	0.15	24.9
1961	963988	51.2	27.6	13.9	7.3	0.14	24.3
1971	1243693	53.3	26.4	13.2	7.1	0.13	23.8
1981	1584440	52.4	26.6	14.5	6.4	0.12	24.1
1991	1956196	48.3	30.0	14.7	7.0	0.15	25.2
2011	1739825	38.1	32.1	20.1	9.6	0.26	28.8

Regjistrimi i popullsisë 2011 (përkundër mangësive dhe kritikave) për herë të parë tregon për tendencë të rënies të popullsisë së Kosovës për -11.1% krahasuar me vitin 1991. Popullsia e grup moshave të reja (0-19 vjet) përbëhej prej 662509 persona ose 38.1% (nga 52.4%-1981) ndërsa popullsia e vjetër (mbi 60 vjet) numëronte 169870 persona ose 9.6% (nga 6.4%-1981) të popullsisë

së përgjithshme. Sipas rezultateve të prezantuara popullsia e Kosovës i takonte grupit të popullatave në prag të moshimit në të cilat kontingjentin më të madh të popullsisë e përbënin grup moshat e pjekura ndërsa pjesëmarrja e grup moshave të vjetra ishte mbi 8%.

Në analizën e dinamikës së ndryshimeve të popullsisë sipas moshës në periudhën 1981-2011, mundë të konstatohen ndryshime në favor të grup moshave të vjetra. Kështu numri i popullsisë së re është zvogëluar për 165762 persona (në raport me 1981) dhe 281301 (me 1991), ndërsa pjesëmarrja në popullsisë e përgjithshme u zvogëlua për -20.1% (1981) dhe -29.8% (1991).

	1981	%	1991	%	2011	%	Indeksi 2011/1981
0-4	235912	14.9	263302	13.5	149735	8.6	63.5
5-9	221376	14	238690	12.2	160916	9.2	72.7
10-14	198699	12.5	228537	11.7	176926	10.2	89.1
15-19	172284	10.9	213281	10.9	174932	10.1	101.5
20-24	140052	8.8	187693	9.6	161467	9.3	115.3
25-29	111499	7	162378	8.3	141268	8.1	126.7
30-34	92034	5.8	131835	6.7	130542	7.5	141.8
35-39	76214	4.8	104208	5.3	124912	7.2	163.9
40-44	73758	4.7	86227	4.4	108142	6.2	146.6
45-49	64328	4.1	71768	3.7	94988	5.5	147.7
50-54	55533	3.5	69403	3.5	80625	4.6	145.2
55-59	35975	2.3	59264	3.1	65539	3.8	182.2
60-64	29302	1.8	49748	2.5	53048	3	181.1
65-69	26235	1.7	30593	1.6	44056	2.5	167.9
70-74	22291	1.4	22762	1.2	33807	1.9	151.7
75+	23901	1.5	36507	1.7	38922	2.2	162.8
Gjithsej	1584440	100	1956196	100	1739825	100	1.09

Tabela 5. Trendi i lëvizjes së numrit të popullsisë sipas grup moshave 1981-2011²³.

Grup moshat e reja të pjekura (20-39 vjet) në raport me vitin 1981 ka treguar rritje për 138390 persona dhe zvogëlim për -27925 persona krahasuar me 1991, ndërsa pjesëmarrja në popullsinë e përgjithshme është rritur 26.6 (1981) në 32.1% (2011), ndërsa në raport me vitin 1991 është zvogëluar për -4.8%. Popullsia e grup moshave të pjekura të moshuara (40-59 vjet) kanë treguar tendencë të vazhdueshme të rritjes për 119700 persona në raport me 1981 dhe 92632 me 1991, ndërsa pjesëmarrja në popullsinë e përgjithshme është rritur për 52.1%.

Grup moshat e vjetra të popullsisë (+ 60 vjet) gjithashtu kanë treguar rritje të vazhdueshme për 68141 persona në raport me vitin 1981 dhe 32981 me vitin 1991, ndërsa pjesëmarrja në popullsinë e përgjithshme është rritur për 67.1%.

²³ Behrmi S., Bajraktari F.,(2015). “The demographic aging process in Kosovo- perspectives and challenges”, 18th International Information Society – IS 2015 Multiconference”, Facing Demographic Challenges. Volume B. Ljubljana , Slovenia.

Për trendin e moshimit demografik tregojnë edhe indikatorët tjerë të moshimit demografik të popullsisë- indeksi i moshimit dhe moshë mesatare. Në periudhën e studimit moshë mesatare e popullsisë së Kosovës është rritur për 4.8 vjet (nga 24 vjet-1981 në 28.8 vjet në 2011). Gjithashtu edhe indeksi i moshimit demografik (raporti në mes numrit të moshuarve dhe të rinjve) është rritur nga 0.12 në 0.26. Në bazë të ndryshimeve në strukturën e popullsisë sipas moshës mund të përfundohet se popullsia e Kosovës ndodhet në prag të moshimit demografik.

Për trendin e shpejt të përkeqësimit në strukturën e popullsisë sipas moshës drejt moshimit demografik flet e dhëna se deri sa në vitin 2011 grup moshat mbi 60 vjet përbënin 9.6% të popullsinë, në vitin 2018 kjo pjesëmarrje rritet në 12.1%. Në të njëjtën kohë grup moshat 0-19 kanë treguar tendencë të zvogëlimit të pjesëmarrjes nga 38.1% në 34.2%.

(S. Behrami: "Krizë demografike e Kosovës në dy dekadat e shek. XXI". <https://www.albinfo.ch/kriza-demografik-ne-kosoves-ne-dy-dekadat-e-shek-xxi/>).

1.3. Perspektiva e strukturës së popullsisë sipas moshës deri me 2061- varianti i mesëm

Rezultatet e parashikimit tregojnë se trendët demografike në Kosovë deri në vitet e '30 të shek. XXI do të jenë pozitive (për disa parametra demografik), pas të cilave Kosova do të karakterizohet me trendë të zvogëlimit të vazhdueshëm të numrit të përgjithshëm të popullsisë-procesi i depopullimit dhe do të përfshihet nga ndryshime të theksuara në strukturën e popullsisë sipas moshës të cilat do të përcjellën me pasoja të shumta jo vetëm në sferën demografike por edhe atë socio-ekonomike. Mesi i viteve të '30 të këtij shekulli shënon periudhën kur popullsia e moshuar do të mbizotëroj grup moshat e reja dhe do të filloj procesi i depopullimit i cili në dekadat në vazhdim do të thellohet me trend të përshpejtuara. Kështu popullsia e grup moshave të reja dhe afta për punë do të jetë gjithnjë e më e vogël, ndërsa ato të moshuara në rritje.

Vitet	Popullsia e përgjithshme.	0-19	20-39	40-59	Mbi 60	Indeksi i moshimit
2011	1739825	662509	558189	349294	169870	0.26
	%	38.1	32.1	20.1	9.6	
2021	1883805	564459	614004	450889	254453	0.45
	%	29.9	32.6	23.9	13.5	
2031	1931957	493936	581584	501370	355067	0.72
	%	25.6	30.1	25.9	18.4	
2041	1923175	431796	483506	542999	464876	1.08
	%	22.5	25.1	28.2	24.2	
2051	1859447	355269	426032	524840	553305	1.56
	%	19.1	22.9	28.2	29.8	
2061	1743470	295055	367804	435801	644812	2.19
	%	16.9	21.1	24.9	36.9	
2031/2011	11.0	-25.4	4.2	43.5	109.1(2.1 here)	
2061/2011	0.21	-55.5	-34.1	24.8	279.6(3.8 here)	

Tabela 6. Perspektiva në strukturën e popullsisë sipas moshës në Kosovë 2011-2061²⁴.

Trendin e përkeqësimit të strukturës së popullsisë sipas moshës më së miri e vërteton fakti i rritjes së popullsisë sipas grup moshave ku grup moshat 0-19 vjet në periudhën 2011-2061 do të tregojnë trendë të rënies për -55.5% (më tepër se përgjysmim), grup moshat 20-60 vjet do të jenë stabile por me tendencë të rënies -11.4%, ndërsa grup moshat mbi 60 vjet do të tregojnë rritje për (279.6 %) ose për afër 4 here (3.8 here). Në të njëjtën periudhë popullsia e përgjithshme do tregoj tendencë të rritjes për vetëm 0.21%, ndërsa nivelimi i numrit dhe pjesëmarrjes në mes gro moshave të reja dhe atyre të moshuara pritet të ndodhë rreth vitit 2035.

5.4. Rritja e kontingjentit të të moshuarve

Në periudhën 2011-2061 e vetmja kategori e cila do të ketë rritje të vazhdueshme do të jenë grup moshat mbi 60 vjet. Në raport me vitin 2011, në 2031 kjo gruposh do të rritet për 185197 persona (109.1%) që do të thotë se do të dyfishohet, ndërsa me 2061 rritja do të jetë shumë e shpejt për 474942 (279.6 %) ose për afër 4 here (3.8 here). Pjesëmarrja e grup moshave mbi 60 vjet në popullsinë e përgjithshme do të rritet nga 9.6 % (2011), në 18.4% (2031) për të arritur në 36.9% (2061).

Trend shumë të shpejt të rritjes do të kenë sidomos grup moshat shumë të vjetra (mbi 75 vjet). Në vitin 2031, popullsia e kësaj kategorie do të rritet për 56966 (137.8%), ndërsa në vitin 2061 për 211191 (510.8%) ose për më tepër se 6 here që është shumë më e shpejtë se sa rritja e popullsisë së moshuar. Pjesëmarrja e popullsisë shumë të moshuar në kuadër të popullsisë së moshuar do ta rrit pjesëmarrjen nga 33.6% (2011), në 38.9% (2031) dhe 49.9% (2061). Popullsia e re gjatë gjithë periudhës do të tregoj tendencë të zvogëlimit për -168573 persona ose -25.4% (2031) dhe për -367454 persona ose -55.5% (2061), ndërsa pjesëmarrja në popullsinë e përgjithshme do të zvogëlohet nga 38.1% (2011), në 25.6% (2031) dhe 16.9% (2061).


Edhe treguesi tjetër- Indeksi i vjetërsisë (moshimit- numri i popullsisë mbi 60 vjet ne 100 të rijë 0-19 vjet) tregon për tendencë të përshpejtuar të moshimit demografik të popullsisë në Kosovë sidomos pas viteve të '30 të shek. XXI. Në vitin 2031, indeksi i moshimit do të jetë 0.72, për të arritur në 2.19 me 2061 nga 0.26 sa ishte në 2011. Kështu për deri sa në vitin 2011 në 4 të rijnë vinte një i moshuar, në vitin 2034, një i moshuar do të vine një i ri, ndërsa në vitin 2061, në një të ri do të vinë me tepër se dy (2.3) të moshuar. Në krahasim me vitin 2011, me 2031 indeksi i moshimit do të jetë për 2.8 here, ndërsa ne vitin 2061 për 8.4 here më i lartë²⁵.

Në kushtet e rritjes së pjesëmarrjes së popullsisë së moshuar dhe shkallës së ulët të lindshmërisë, piramida e popullsisë në Kosovë deri në dekadën e IV të shekullit XXI, do të ketë tiparet e

²⁴ "Parashikimi i Popullsisë së Kosovës 2011-2061". Agjencia e Statistikave të Kosovës. Prishtinë 2013. Të dhënat i përpunoi autori.

²⁵ Behrami S.et al. (2014) "Challenges of Kosovo Demographic Roadmap in the Future". Facing Demographic Challenges. Volume B. Ljubljana.

piramidës regressive nga tipi progresiv i vitit 1991 (shih tabelën 6 dhe piramidat)²⁶. Siç mund të konstatohet edhe nga piramida e popullsisë, për deri sa në vitin 1981 grup moshat me numrin më të madh të individëve ishin ato 0-14 vjet, në vitin 2011 pjesëmarrje më të madhe kanë ato 14-24 vjet, në vitin 2031 parashihet të dominojnë grup moshat 34-44 vjet ndërsa në vitin 2061 ato të moshuara 60-74 vjet.



Sipas kategorizimit të UN popullsia e Kosovës në vitin 2011 ishte në prag të moshimit, ndërsa zhvillimet në të ardhmen do të jenë të pa favorshme si nga këndvështrimi demografik ashtu edhe socio- ekonomik kur popullsia e Kosovës do të futet në proces të thellë të moshimit. Kështu për

²⁶ Behrami S.et al. (2014) “Challenges of Kosovo Demographic Roadmap in the Future”. Facing Demographic Challenges. Volume B. Ljubljana.

6 dekada e shek. XXI, popullsia e Kosovës sa i përket strukturës së popullsisë sipas moshës do të kalojë nga tipi progresiv në tip regresiv të popullatave.

Në fund duke u bazuar në Parashikimin e Popullsisë së Kosovës 2011-2061 i përgatitur nga ASK, vitet e '30 të shekullit XXI do të jenë vite kthese- negative në zhvillimin demografik të Kosovës. Kjo korrespondon me kohën kur Kosova për herë të parë do të ballafaqohet me: fillimin e procesit të depopullimit, në strukturën e popullsisë sipas moshës grup moshat e vjetra do të dominojnë grup moshat e reja, shënon fazën e fillimit të zvogëlimit të kontingjentit të popullsisë aktive etj. Rritja e përshpejtuar e kontingjentit të popullsisë së moshuar- moshimi demografik dhe zvogëlimi i kontingjentit të rinjve do të ketë implikime negative në të gjitha sferat e jetës në Kosovë. Prandaj për plotësimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zhvillim të qëndrueshëm demografike të vendeve, rajoneve, komunave etj., është e domosdoshme që ruhen korrelacionet optimal në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë .

5.5. Sfidat e moshimit demografik

Trendi i zhvillimeve demografike në masë të madhe do të ndikohen nga moshimi i popullsisë, kështu që edhe zhvillimi i qëndrueshëm në masë të konsiderueshme do të varet nga suksesi i shoqërisë kosovare për të përballuar këtë sfidë. Moshimi demografik si proces karakterizohet me pasojë të shumta negative si në sferën demografike ashtu edhe në atë socio- ekonomike.

Sa i përket perkusioneve demografike të moshimit të popullsisë në radhë të parë ndikojnë në: zvogëlimin e shkallës së rritjes së popullsisë, në nivelin e natalitetit (me zvogëlimin e kontingjentit fertil që nënkupton zvogëlimin e shkallës së lindshmërisë), në rritjen e shkallës të mortalitetit , në lëvizjet migruese, në përkeqësimin e më tejme në strukturës së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë etj.

Në aspekt socio-ekonomik perkusionet negative të moshimit të popullsisë shprehen përmes zvogëlimit të kontingjentit të popullsisë shkollorë, të numrit të popullsisë së moshës së punës, në nivelin e aktivitetit ekonomik, plakjen e fuqisë punëtore (zvogëlimi i produktivitetit), rritjen e presionit në fondet personale, shëndetësore etj .

Pesha e ndikimeve të zhvillimeve demografike duke përfshirë edhe moshimin demografik e vërtetojnë statistikën e zvogëlimi i kontingjentit të popullsisë shkollorë- kontingjenti i fëmijëve në shkollim fillor (6-14 vjet), kontingjentin e shkollimit të mesëm (15-19 vjet), kontingjenti universitar (shih statistikën e arsimit faqe 49.) si dhe zvogëlimi dhe moshimi i kontingjentit të punës- kontingjenti i popullsisë aktive (15-64 vjet) dhe kontingjentit të moshuar të punës (mbi 50 vjet), (shih statistikën ekonomike faqe 43) .

Moshimi demografik në radhë të parë është pasojë e rënies së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë, ndërsa në Kosovë faktori kryesor është emigrimi selektiv i popullsisë sipas grup moshave. Si proces, ka implikime negative dhe afatgjata në zhvillimin e më tejme demografik, shoqëror dhe ekonomik. Shekulli 21 do të jetë shekulli i të moshuarve me tendencë intensive të moshimit, i cili si proces deri me sot nuk është shënuar në historinë e njerëzimit. Ndryshime të tilla të strukturës moshore të popullsisë do të paraqiten si faktor (më) i rëndësishëm si për vendet e zhvilluara e po

ashtu edhe për ato në zhvillim i cili kërkon përgjigje sa më të shpejt si në nivel global po ashtu edhe në atë lokal.

Për shmangen e pasojave nga moshimi demografik me të cilat ballafaqohen shumë vende evropiane në Kosovë është e nevojshme ruajtja e gjendjes së tanishme dhe ndërmarrja e masave në : a) ruajtjen e nivelit të lindshmërisë në gjendjen e tanishme dhe ndalimin e rënës së më tej të tij, b) përgatitje të strategjive sektoriale (lindshmërisë, punësimit etj.) dhe c) punësimi i të rinjve në mënyrë që të ndalohen emigrimet nga Kosova.

Fakti që koha në mes ndërmarrjes dhe efekteve të masave në demografi është relativisht e gjatë e bëjnë të domosdoshme që politikat në sferën demografike në Kosovë të jenë të menjëhershme me qenë se për më pak se një dekadë, Kosova pritet të ballafaqohet me probleme demografike. Shumë vende të cilat përballen me probleme të kësaj natyre zgjidhjen e tyre e kërkojnë përmes imigrimit nga vendet tjera, ndërsa Kosova me nivelin e zhvillimit nuk mundë të llogaris në këtë politik. Përkundrazi, gjendja sa i përket emigrimeve mundë edhe të përkeqësohet edhe më tepër me rastin e liberalizimit të vizave dhe integrimin e Kosovës në EU e cila mundë të nxis valë në rritje të emigrimeve duke pasur parasysh faktin se Kosova ngel prapa vendeve të EU në sferën socio-ekonomike e një ndër faktorët kryesor të migrameve është dallimi në nivelin e zhvillimit socio-ekonomik në mes vendeve të prejardhjes dhe mikpritëse.

Në rastin më të mirë ruajtjen e nivelit të lindshmërisë në gjendjen e tanishme dhe ndalimin e rënës së më tej do të ishte zgjedhja më e mirë për të ardhme të qëndrueshme demografike të Kosovës që nënkupton që gjenerata e ardhshme minimumi të jetë me madhësi të njëjtë si e tanishmja. Kosova duhet të adresoj sfidat që vijnë nga plakja e shpejte e popullsisë dhe zvogëlimi i fuqisë së punës duke forcuar sistemon e mbrojtjes sociale dhe pensione²⁷.

²⁷ Global Trends. Challenges and Opportunities in the Implementation of the Sustainable Development Goals., UNDP and United Nations Research Institute for Social Development, 2017.

2. MIGRIMET E POPULLSISË

Migrimi e popullsisë do të jenë tipar përcaktues i zhvillimeve demografik të shekullit XXI, te cilat kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha aspektet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, dhe si i tillë do të jetë thelbësor për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm për herë të parë pranon kontributin e migracionit për ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Lidhja midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe rolit të migracionit është rëndësishëm për të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm. Fakti që migracioni është i rëndësishëm për 10 (objektiva 1,3,4,5,8,10,11,13,16 dhe 17) nga 17 OZHQ dhe shumicën e 169 synimeve në Agjendë tregon për rolin dhe rëndësinë e migrimëve në përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030. Agjenda specifikisht në objektiven 10.7, kërkon: lehtësimin e migrimëve, migracion të sigurt, të rregullta dhe të përgjegjshëm", zbatimin dhe menaxhimin e mirë të "politikave të migrimit". Fakti që migrimet janë të rëndësishme për përmbushjen e shumicës së OZHQ, i bën emigrimet jo vetëm nevojë por edhe domosdoshmëri të trajtimit dhe përfshirjes me qëllim të arritjes në përmbushjen e Agjendës 2030.

Një konfirmim tjetër i lidhjes së ngushtë midis synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe migracionit është fakti që migrantët, refugjatët dhe personat e zhvendosur janë grupe të njerëzve në nevojë, nevojat e të cilëve duhet të adresohen në mënyrë që "askush të mos ndihet i lënë pas dore", që është një nga parimet kryesore të Agjendës 2030 të KB.

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve në vitin 2013 u hartua agjenda tetë pikësh e cila i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar që: të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave për të gjithë emigrantët, të ulë kostot e migracionit, ti epet fund shfrytëzimit të emigrantëve, të trajtohet gjendja e emigrantëve në vështirësi, të përmirësojë perceptimin publik të emigrantëve, të integroj migracionin në agjendat zhvillimore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm, të fuqizoj bazën e dëshmive të migrimit dhe të thellojë partneritetet dhe bashkëpunimin rreth migrimit.

Në periudhën 2000-2019, Kosovën e kanë braktisur 371.390 banorë (sipas statistikave të ASK), me mesatare prej 19.543 banor brenda vitit edhe pse paraprakisht ekzistonte bindja se me lirin dhe pavarësinë, Kosova do të shërohej edhe nga kjo plagë e vjetër shekullore.
(S. Behrami: "Kriza demografike e Kosovës në dy dekadat e shek. XXI".
<https://www.albinfo.ch/kriza-demografik-ne-kosoves-ne-dy-dekadat-e-shek-xxi/>).

Agjenda 2030, migrimet e popullsisë sidomos ato ndërkombëtare i trajton si mundësi e madhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm, nëse migrimet menaxhohen mirë dhe përcillen me masa e politika të mirëfillta të cilat në Kosovë fatkeqësisht mungojnë. Mungesa e masave dhe politikave adekuate ka ndikuar që përveç remitancave efektet pozitive të migrimëve në sferën e zhvillimit në Kosovë të jenë

minimale. Në të kundërtën efektet negative janë shumë më të mëdha duke filluar nga: zhvillimet demografik, socio- ekonomik e edhe të sigurisë në vend.

Emigrimi i popullsisë nga Kosova në vendet evropiane nuk është fenomen i ri. Kosova gjatë gjithë shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI ishte dhe mbeti territor tipik emigruese. Shkaktaret kryesor të cilat detyruan popullsinë të emigroj ishin dhe mbeten: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkatërrimet nga luftërat si dhe situata jo e favorshme politike etj. Ekzistojnë edhe arsye tjera që ndërlidhen me emigrimin siç është pakënaqësia e qytetarëve të Kosovës me gjendjen aktuale të perspektivës socio-ekonomike dhe me nivelin e përgjithshëm të mirëqenies manifestuar këto me shkallë të lartë të papunësisë, sidomos në mesin e të rinjve dhe përçindja të lartë të njerëzve që jetojnë në varfëri etj.

Çështjet ekonomike që lidhen me papunësinë dhe varfërinë janë edhe shqetësimet kryesore të qytetarëve të Kosovës. Hulumtimet e fundit të opinionit tregojnë se këtë dy parametra ekonomik janë edhe kërcënime të sigurisë kombëtare me të cilat përballet Kosova. Sipas këtyre të dhënave rreth 70 % e të anketuarve besonin se shkalla e lartë e papunësisë është kërcënimi më i madh për Kosovën. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe numrin e madh të njerëzve që jetojnë në nivelin e varfërisë, emigrimi shihet si mundësi nga qytetarët e Kosovës për të gjetur një perspektivë më të mirë shoqërore dhe ekonomike jashtë vendit duke i shndërruar emigrimet në rrezik për zhvillimet demografik, socio- ekonomik e edhe të sigurisë në vend.

Emigrimet- nga Kosova fatkeqësisht vazhduan me përmasa shqetësuese edhe pas luftës së vitit 1999. Kështu në periudhën 2000-2019, Kosovën e kanë braktisur 371.390 banorë (sipas statistikave të ASK), me mesatare prej 19.543 banor brenda vitit edhe pse paraprakisht ekzistonte bindja se me lirin dhe pavarësinë, Kosova do të shërohej edhe nga kjo plagë e vjetër shekullore. Kontingjenti i emigrantëve pa dyshim që është edhe më i madh kur dihet fakti i emigrimeve ilegale të kosovarëve dhe emigrimi me pasaporta të vendeve tjera.

Edhe më shqetësues është fakti se bazuar në sondazhe të ndryshme të realizuara në vend, mbi 50% e të anketuarve kanë shprehur dëshirën të ikin nga Kosova kryesisht gjenerata të reja (20 deri në 40 vjet) të cilët përbejnë kontingjentin kryesor demografik dhe lindshmërisë, kontingjentin e punës, të sigurisë etj., duke shkaktuar rënie të “kapitalit human”, si bartësin kryesor të zhvillimit socio-ekonomik.

Duke pasur parasysh ecurinë e gjertanishme por edhe atë që pritet në zhvillimin ekonomik, mundësitë e punësimit dhe rrethanat tjera të pavolitshme, edhe për një kohë duhet të priten lëvizje migruese të popullsisë me intensitet të pa zvogëluar. Fatkeqësisht institucionet e Kosovës nuk ka bërë asgjë ose shumë pak në adresimin e faktorëve nxitës të emigrimit siç janë: zhvillimi ekonomik, papunësia, perspektiv për jetë të sigurt, më të mirë, më të dinjitetshme etj.

Parashikimet tregojnë se emigrimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen mirëpo si pasojë e zvogëlimit të kontingjentit të popullsisë në moshën e prirë për emigrim, nga fillimi i dekadës së tretë të shek. XXI, pritet rënie e personave që do të emigrojnë. Gjendja sa i përket emigrimeve mundë edhe të përkeqësohet edhe më tepër me rastin e liberalizimit të vizave dhe bashkimit të Kosovës me EU e cila mundë të nxis valë në rritje të emigrimeve duke pasur parasysh faktin se

Kosova ngel prapa vendeve të EU në sferën socio-ekonomike pasi që një ndër faktorët kryesor të migrimeve është dallimi në të ardhura në mes vendeve të prejardhjes dhe mikpritëse.

Pasojat demografik- pasojat e emigrimit sidomos të të rinjve janë të dukshme në karakterin demografik të popullatës. Emigrimet ndikojnë në madhësinë e popullsisë duke shkaktuar humbjen e asaj pjese të popullsisë, e cila përbën potencial zhvillimi, nivelin e lindjeve (me rënie të lindjeve), fertilitetit, rritjes natyrale së popullsisë dhe strukturat e popullsisë (demografike, ekonomike, sociale, etnike dhe të tjera) përcjell kjo me shpopullim natyror, emigracionin e trurit (brain drain), plakjes të popullsisë etj.

Si pasoj e emigrimeve Kosova që nga periudha pas luftës së vitit 1999 ka treguar tendencë të stagnimit dhe zvogëlimit në numrin e përgjithshëm të popullsisë, ulje te numrit të lindjeve për 87.7% ose 1.9 here dhe shtimit natyror për 147.3% ose 2.5 here (2000/2018), rritje të pjesëmarrjes së grup moshave të vjetra te popullsisë nga 9.6%(2011) në mbi 12% (2018). etj. Efektet negative të lëvizjeve migruese janë përcjell ne shumë segmente të jetës me theks të veçantë në lëvizjen e përgjithshme të numrit të lindjeve, rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë së moshuar, zvogëlimin e numrit të nxënësve ne te gjitha nivelit e sistemit arsimor etj.

Shqetësuese është fakti i emigrimit të ekspertëve dhe shkencëtarëve- Ikja e trurit nga Kosova, fenomen i cili ka marr përmasa shqetësuese e që paraqet pasoja negative të zhvillimit të vendit. Emigrantët me shkollim të lartë universitar përbënte më tepër se 1/3 e numrit të përgjithshëm të emigrantëve (rreth 35%), sipas të cilës Kosova zënë ndër vendet e para jo vetëm në Evropë por edhe në nivele botërore. Problemi i shpërnguljes së një fuqie punëtore të arsimuar manifestohet përmes fondeve të investuara në arsim për përgatitje për tregun e punës e me rastin e emigrimit vendet imigruese pranojnë fuqi të kualifikuar pa investuar fare ne këto kontingjente, për të rritur më vonë produktin vendas të vendit ku emigrojnë.

Pasojat socio- ekonomik - një nga segmentet më të goditura nga emigrimit është edhe sfera ekonomike, ku papunësia është motivuesi kryesor për emigracionin. Emigrimi i popullsisë ka ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të vendit përmes: rritjes së ulët e PBB-së percapita, ngadalësimi i rritjes ekonomike, humbjen e fuqisë punëtore, ulja e konkurrencës dhe ndikimi negativ në sistemin shoqëror dhe pensionet, emigrimin e personave të kualifikuar etj. Kosova me shkallë të papunësisë prej mbi 30% (te grup moshat e reja papunësia arrin edhe deri në 50%), shkallë të varfrës rreth 20 %, standardin e ulët të jetesës, nivelin e ulët të pagave (më të ulët në rajon) parqet vend me potencial shumë të lartë të emigrimit. Numri i lart i emigrimeve tregon pasigurinë e tyre për të ardhmen në vendlindje.

Sipas ekspertëve te ekonomisë në periudhën pas luftës, Kosova ka pasur një rritje ekonomike të pamjaftueshme dhe e cila nuk mund të konsiderohet rritje e qëndrueshme për të zbutur problemet ekonomike dhe sociale, siç janë papunësia dhe varfëria. Në aspekt social pasojat janë të dukshme. Kosova po plaket me ritme të shpejta. Emigrimi i te rinjve po shkakton rritjen e numrit të qytetarëve në moshën e pensionit dhe largimi i fuqisë punëtore përkeqëson statusin social dhe ekonomik të vendit. Largimi i punonjësve te kualifikuar sidomos të të rinjve janë të dukshme përmes humbjes së kapitalit të investuar, investimet e mëparshme të shoqërisë dhe familjes në edukimin e tyre. Shteti u siguron atyre arsim, akordon bursa për studentë të mirë dhe siguron

aftësim profesional, por është shumë e zakonshme që kur përfundojnë në tregun e punës dhe janë më të nevojshëm për shoqëri të shkojë dhe të gjejë punë më të mira në vendet e tjera.

Pasojat për siguri - në shekullin XXI, emigrimet e popullsisë nuk trajtohet më vetëm si humbje në sferën demografike dhe sociale, por gjithnjë e më tepër po trajtohen edhe në kontekstin e ndikimit në sigurinë lokale dhe atë globale. Viteve të fundit në literature demografike gjithnjë e më tepër po gjene përdorim koncepti i "sigurisë demografike" i cili nënkupton rënien e popullsisë dhe lëvizjet negative demografike si çështje të sigurisë së përgjithshme, ku këto lëvizje mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare qoftë në aspekt të fuqisë ushtarake, ekonomike etj., në krahasim me grupet e caktuara brenda vendit ose edhe në raport me vendet fqinje.

Megjithatë, koncepti i "sigurisë" nuk barazohet vetëm me sigurinë ushtarake, por përfshin edhe lloje të tjera, të tilla si siguria demografike, ekonomike, ekologjike, politike e dhe më shumë. Pa siguri veprimtaria e njeriut është joefikas dhe nganjëherë e pakuptimtë. Krijimi i kushteve për njerëzit e sidomos për rinin që të kenë besim në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre është çelës për ndalimin e emigrimit nga Kosova. Nëse popullsia veçanërisht të rinjtë kanë qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor cilësor, nëse janë në punësim të qëndrueshëm dhe marrin mbështetje për rritjen e fëmijëve, ata kanë më pak gjasa të emigrojnë dhe kanë më shumë gjasa të vendosin që karrierën ta ndërtojnë në vendlindje. Aksioni shtetëror është veçanërisht i rëndësishëm në drejtim të zbutjes së shkaqeve të fluksit të emigracionit.

Duhet të jenë ekspertet e fushave të ndryshme dhe jo politikanët që duhet të thonë fjalën e tyre se çfarë duhet bërë, ku duhet të përqendrohemi për të penguar pasojat negative të këtij procesi i cili po i merr vendit grupet e popullsisë së aftë për: riprodhim biologjik, zhvillim ekonomik, personat e kualifikuar deri te grupet të cilat mundë të sjellin siguri për vendin. Është e domosdoshme menaxhim i mirë dhe përgatitje e politikave dhe strategjive të mirëfillta për migrimet e brendshme e sidomos ato ndërkombëtare në mënyrë që migrimet të shndërrohen në potencial të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm, Kështu përfshirja e migriimeve në dokumentet e planifikimit do të mundësojnë shfrytëzimin e përfitimeve nga migracionit dhe zbutjen e pasojave negative nga procesi.

7. PERSPEKTIVA DHE SFIDAT NË STRUKTURËN SOCIO-EKONOMIKE

Popullsia është resursi më i rëndësishëm ekonomik i çdo vendi, posaçërisht me aftësitë e tyre profesionale, njohuritë dhe kapital intelektual si pjesë më e rëndësishme e sistemit të ekonomive moderne. Zhvillimet demografike kanë ndikim të konsiderueshëm në madhësinë e grup moshave të ndryshme, përfshirë këtu edhe popullsinë në moshë pune duke përcaktuar madhësinë e fuqisë punëtore në të ardhmen, si dhe numrin e personave në pension.

Sipas eksperteve të fushës së ekonomisë parakusht themelor për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm është popullsia dhe fuqi punëtorë në rritje të vazhdueshme dhe mirë e arsimuar. Zhvillimet demografike përbëjnë faktorin çelës për mbështetje dhe stimulimin e zhvillimit

ekonomik. Vendet me rritje demografike të qëndrueshme, e cila “përkthehet” në burime njerëzore të bollshme në treg, mbi të gjitha në moshë të re, evidentohen njëkohësisht si vende me dinamikë progresive rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm. Sistemet e vendeve të zhvilluara “për tërheqjen e emigrantëve të rinj dhe të kualifikuar” janë pothuajse totalisht në funksion të thithjes së talentëve dhe furnizimit të tregut të punës dhe bizneseve me këtë “lëndë të parë” cilësore e eficiente²⁸.

Kosova karakterizohet me tendenca krejt të kundërt me këtë element kaq të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik: popullsi në stagnim drejt tkurrjes, largime të konsiderueshme të brezit të ri të arsimuar, furnizim i mangët i tregut me fuqi të re punëtore si pasojë e emigrimeve, sistem arsimor që len shumë për të dëshiruar dhe ne shpërputhje me nevojat e tregut të punës etj.

Pika fillestare për studimin e strukturës ekonomike të popullsisë është struktura ekonomike e popullsisë aktive. Studimi i dinamikës dhe strukturës së popullsisë aktive është i rëndësishëm jo vetëm për kërkimet demografike, por edhe për kërkimet ekonomike. Zvogëlimi dhe moshnimi i kontingjentit të punës- kontingjenti i popullsisë aktive (15-64 vjet) do të shënoj trend të rritjes deri në fund të dekadës së dytë të shekullit XXI (2028). Në raport me vitin 2011 popullsia aktive do të rritet për 146490 persona me 2031, ndërsa pjesëmarrja nga 65.3% (2011) në 67.7% (2031). Nga fillimi i dekadës së tretë popullsia aktive do të ketë trend negativ të rritjes. Kështu në raport me vitin 2031, në vitin 2061 popullsia aktive do të jetë më e vogël për -21.9% ose në numër për 286268 persona, ndërsa pjesëmarrja do të zvogëlohet nga 67.7% (2031) në 58.6% (2061).

	Kont. pop. aktive (15-64 vjet)- %	Kont. moshuar i punës (mbi 50 vjet)- %
2011	65.3	17.8
2031	67.7	26.4
2061	58.6	36.9

Tabela 7. Perspektiva e popullsisë aktive në Kosovë 2011- 2061

Në të njëjtën kohë do të rritet pjesëmarrja e kontingjentit të moshuar të punës (mbi 50 vjet), krahas kontingjentit e ri të punës (15-49 vjet). Në vitin 2031 ky kontingjent do të rritet për 139029 ndërsa në vitin 2061 për 170261 persona në krahasim me vitin 2011, ndërsa pjesëmarrja e kontingjentit të moshuar të punës do të rritet nga 17.8% (2011), në 26.4% (2031) për të arritur në 36.9% (2061). Ulja numerike dhe plakja e kontingjentit të punës e vë në dyshim zhvillimin më të shpejtë ekonomik të vendit.

Zhvillimet e përgjithshme demografike sidomos nga dekada e tretë do të përcjellën me ndikime negativ në zhvillimin ekonomik përmes:

- rritje të shpenzimeve për grupeve të varur të popullsisë (kryesisht të moshës mbi 65 vjeç) të cilët financojnë direkt ose indirekt nga të ardhurat e grupeve të popullsisë

²⁸Adrian Civici, “Çfarë kërkon një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm”, <https://shtetiweb.org/2019/09/12/cfare-kerkon-nje-zhvillim-ekonomik-i-qendrueshem/>

aktive. Efekti përfundimtar i rritjes së raportit të grup moshave të varura ndaj popullsisë aktive është ulja e standardit të përgjithshëm të jetesës, përveç nëse ngarkesa kompensohet me rritjen e produktivitetit të prodhuesit;

- rritja e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor si rezultat i rritjes së kostove të kujdesit shëndetësor për të moshuarit;
- ulja e kursimeve nacionale, pasi popullsia e moshuar zakonisht ka kursime negative (konsumon të ardhura të krijuara nga mosha prodhuese);
- zvogëlimi i potencialit të fuqisë punëtore për shkak të hyrjes të zvogëluar të rinjve në tregun e punës;
- ulja e kërkesës për shkak të zvogëlimit të popullsisë dhe rrjedhimisht uljes së furnizimit (prodhimi);
- ulja e motivit për inovacion teknologjik edhe për shkak të zvogëlimit të vëllimit të tregut të brendshëm.

Të dhënat e prezantuara tregojnë për përkeqësim të konsiderueshëm të situatës sa i përket strukturës të kontingjentit të punës. Nga studimet ekonomike është e njohur se fuqia punëtore më e moshuar : më vështirësi i adaptohet përparimeve teknike- teknologjike, ka nivel më të ulët të produktivitetit, nuk është inovative etj. Një çështje e veçantë që ngritët duke shqyrtuar trendin e moshnimit demografik të kontingjentin të punës në Kosovë është qëndrueshmëria e sistemit ekonomik.

Kosova me popullsi të re (për rrethanat evropiane) duhet të shndërroj mundësin demografike në një dividend demografike duke investuar në zhvillimin e kapitalit njerëzorë dhe duke promovuar krijimin e vendeve të reja pune në mënyrë që Kosova të adresoj në mënyrë të duhur dy problemet më të mëdha ekonomike të pas luftës së vitit 1999, papunësinë dhe varfërinë.

Me këtë rast, me qëllim të kapitalizimit të dividendes demografike, është e domosdoshme përfshirja sa më e madhe e femrave në fuqinë punëtore që në të njëjtën kohë do të siguronte të drejta të barabarta dhe siguri në pune në drejtim të plotësimit të OZHQ 5.

Në fund, në aspekt socio- ekonomik, strategjia Evropa 2020 për zhvillim të qëndrueshëm përfshin: rritje të arsyeshme, të arrihet punësim në nivel prej 75% të personave të moshës 20 deri 64 vjet dhe kështu të arrihet në plotësimin e OZHQ 8 për zhvillim të qëndrueshëm që nënkupton “perspektiv të vazhdueshme duke përfshirë: zhvillim dhe rritje të qëndrueshme, punësim, produktivitet të plotë dhe vende pune për të gjithë. ***Fatkeqësisht, Kosova me trendin e tanishëm të zhvillimit e ka të vështir, për mos thënë të pamundur arritjen e kësaj objektive.***

8. PERSPEKTIVA DHE SFIDAT NË SISTEMIN ARSIMOR

*Arsimimi do të jetë një mjet vendimtar për ne,
ta ndryshojmë trendin dhe të ardhmen po ashtu”
Marta Szigetzi Bonifert, REC*

8.1. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit arsimor

Në botën moderne e cila është në ndryshim të vazhdueshëm është e domosdoshme që të fitohen njohuri të reja, që nënkupton ngritje kualitative në sistemin arsimorë. Arsimit është një nga parakushtet themelore për zhvillim të qëndrueshëm pasi që ndryshimi i qëndrimeve tek njerëzit fillon dhe zhvillohet në kuadër të sistemit arsimorë.

Agenda 2030 në OZHQ 4 dhe Agende 21 në pjesën e katërt, kapitullin 35 dhe 36, përfshijnë *sigurimin e arsimit cilësor gjithëpërfshirës, mundësive për mësim gjatë gjithë jetës, rolin dhe rendësin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rolin e trajnimit, ndërgjegjësimin dhe përmirësimin në arsim për zhvillim të qëndrueshëm dhe qëndrueshmërinë e gjeneratave*. Sistemi arsimor është sistem i rregulluar institucional që përfshin mësimin në mënyrë sistematike dhe transmetimin e njohurive të cilat kanë dimension të rëndësishëm social, ekonomik, mjedisor dhe kulturorë.

Arsimi, përveç se është një prej të drejtave themelore të njeriut, në të njëjtën kohë është edhe kusht për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm zhvillon dhe forcon kapacitetet e individëve, të grupeve, komuniteteve, organizatave dhe vendeve për të gjykuar dhe bërë zgjedhje në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm. Ai mund të nxisë ndryshimin e këndvështrimit të njerëzve për një botë më të sigurt, më të shëndetshme dhe më të begatë, duke përmirësuar në këtë mënyrë cilësinë e jetës²⁹, duke e shndërruar arsimin për zhvillim të qëndrueshëm në arsim për jetën, respektivisht mënyrën e sjelljes dhe veprimeve të përditshme.

Kombet e Bashkuara duke konstatuar peshën e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm si dhe për të tërhequr vëmendjen e opinionit botërorë për rendësin dhe rolin vendimtar të arsimit në arritjen e qëllimeve në zhvillimin e qëndrueshëm, periudhën 2005-2014 e shpallen Dekada e Arsimit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Qëllimi i KB me këtë deklaratë ishte që të aftësoj brezat për identifikimin e problemeve ekzistuese të qëndrueshmërisë në nivel lokal dhe global, për të vlerësuar këto probleme dhe në mënyrë aktive të merr pjesë në procesin e zhvillimit dhe krijimit (formimit) e së tashmes dhe të së ardhmes të qëndrueshme.

Në zhvillimit dhe krijimit të së tashmes dhe të së ardhmes faktorët demografik (dinamika demografike) është element i rëndësishëm në përcaktimin e drejtimit të zhvillimi socio-ekonomi të një vendi e me këtë rast edhe për qëndrueshmërinë në zhvillimin e arsimit. Banka Botërore duke u bazuar në definicionin më të përhapur të zhvillimit të qëndrueshëm (Komisionit Bruntland), zhvillimin e qëndrueshëm e definon si: *zhvillimi i cili përfshin kalimin e një rezerve të barabartë apo sipas*

²⁹ Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm- dokumente ndërkombëtare, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC).Shqipëri.

mundësive më të mëdha të kapitalit njerëzor, ekonomik dhe social, tek brezat e ardhshëm³⁰, duke i dhënë kështu zhvillimit të qëndrueshëm një dimension tjetër të rëndësishëm që është dimensionimi demografik.

Kosova edhe pse ende nuk karakterizohet me probleme të theksuar demografike, trendi në rrënje i lindshmërisë dhe emigrimet për një periudhë të gjatë kohore kanë shkaktuar probleme të ndryshme në sfera të ndryshme të jetës duke përfshirë këtu edhe sistemin arsimor me zvogëlim të numrit të vazhdueshëm të nxënësve në arsimin fillor, të mesëm dhe së fundmi edhe atë universitarë.

8.1.1. Sa është i qëndrueshëm zhvillimi i arsimit në Kosovë

Edhe pse si pasoja më të rënda të krizës demografike llogariten: pasojat në trendin e fuqisë punëtore- tregun e punës, sistemin e mbrojtjes sociale, sistemin shëndetësorë etj, në realitet norma e ulët e lindshmërisë në periudha afatgjate më së tepërmi godet kontingjentet e popullsisë të moshave shkollore (5-24 vjet).

Duke u bazuar në definicionet e Banka Botërore për zhvillim të qëndrueshëm dhe në zhvillimin qëndrueshëm demografik-SUSTENDEMO i cili përbehet nga dimensionimi kuantitativ dhe kualitativ kemi shqyrtuar qëndrueshmërinë e arsimit në Kosovë duke u bazuar në dy parametra kuantitativ (shtimin natyror dhe migrimet) dhe një kualitativ (arsimin) respektivisht të lëvizjes së numrit të nxënësve në varësi të shtimit natyror të popullsisë.

Periudha 1990- 1999, në Kosovë karakterizohet me zhvillime negative në të gjitha sferat e jetës duke përfshirë edhe sferën demografike, e përcjell kjo me emigrime masive të cilat fatkeqësisht vazhduan edhe pas luftës së vitit 1999, të cilat u manifestuan me rrënje në nivelin e lindshmërisë, martesave etj, ndërsa në sistemin arsimor për pasoj kishte zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve në nivelin e shkollimit fillorë. Krahasuar me përdhën me normë më të lartë të lindshmërisë (1988), në vitin 2019, lindshmëria ka treguar ulje prej -61.3% (- 34485 lindje) e cila është përcjellë me zvogëlim të numri i përgjithshëm të nxënësve për -30.6% (-106926 nxënës).

Rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 treguan të gjitha anët negative të zhvillimeve politike, sociale dhe ekonomike të dekadës së fundit të shek. XX në sferën demografike të cilat pa dyshim se do të përcjellën me pasojat negative në sferat tjera të jetës duke përfshirë edhe sistemin arsimor në Kosovë.

Trendët negative demografike (sidomos emigrimet) të cilat vazhduan edhe pas luftës së vitit 1999 u përcollën me rrënje të vazhdueshme në normën e lindshmërisë, bilanc negativ migrues dhe zvogëlimin e nxënësve në arsimin fillorë. Në periudhën 2000-2020 numri i të lindurve në Kosovë është zvogëluar nga 38.687 (lindjet vetëm në Kosovë), në 21.798 (2019), që nënkupton rënie për 16.889 lindje ose gat përgjysmim të lindjeve (-43.6%), ndërsa krahasuar me periudhën më produktive të lindshmërisë (1988), numri i lindjeve është zvogëluar prej -61.2% më tepër se përgjysmim, ose në shifra absolute mbi 34 mijë lindje më pakë.

³⁰ Banka Botërore, Shqipëria: rruga drejt një zhvillimi të qëndrueshëm., Marr nga; www.bankofalbania.org/web/pub/sybi_hida_280_1.pdf.

Sa i përket emigrimeve, Kosovën në periudhën në periudhën 2000-2019, Kosovën e kanë braktisur 371.390 banorë, me mesatare prej 19.543 banor brenda vitit. Sa i përket strukturës socio-demografike, ‘proleteriat’ jashtë atdheut që nga fillimi i shkuarjes në vendet e huaja i përket moshës së re, periudhës fertile, biologikisht të shëndosh, kryesisht i gjinisë mashkullore, i kualifikuar ose i ri kualifikuar në vendet e punës të shteteve imigruese etj³¹.

Lëvizjet e tilla të komponentëve demografik negativisht janë manifestuar në lëvizjen e numrit të nxënësve në arsimin fillorë, të mesëm dhe universitar në Kosovë.

Viti	1988	2000	2004	2008	2010	2012	2015	2019
Lin.	56283	38687	35063	34399	33751	34932	31116	21798
SHN.	46026	31572	28664	27547	26517	27093	22232	15294
Nxë.	350103	320843	327207	322975	301486	286677	258464	243177

Tabela 8. Trendi i lindshmërisë dhe numrit të nxënësve në Kosovë 1988-2019 (nr. absolut)

Në arsimin fillor dhe i mesëm të ulet në periudhën 2007-2020, numri i nxënësve është zvogëluar për -87.585, nxënës ose për -26.9%. Kosova në këtë periudhë ka humbur ¼ e numrit të nxënësve. Kështu, Kosova në vitin 2020 kishte 4610 paraleleve më pak se në vitin 2007 (19 nxënës për paralele). Statistika edhe me shqetësuese janë ato të numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e parë ku rënia është edhe më e madhe.

Edhe pse në arsimin e mesëm të lart ndikimi i zhvillimeve negative pritej të shfaqej më vonë megjithatë nga viti shkollor 2011/2012 edhe ky nivel i shkollimit karakterizohet trendë negative me zvogëlim të numrit të nxënësve. Kështu në raport me vitin 2007 numri i nxënësve në vitin 2020 është zvogëluar për më shumë se 12 mijë, ndërsa në raport me vitin 2012 për më shumë se 30 mijë nxënës.

Vetëm në universitetet e Kosovës në këtë periudhë është shënuar rritje e numrit të studentëve edhe pse edhe në këtë nivel në katër vitet e fundit janë shënuar trendë shqetësuese të zvogëlimit të numra të studentëve. Në raport me vitin 2007, në vitin 2020 numri i studentëve është rritur për rreth 50 mijë student (si pasojë e shtimit të pakontrolluar të Universiteteve dhe Kolegjeve Private). Në katër vitet e fundit numri i studentëve është zvogëluar për mbi 50 mijë (50.471) që është treguesi më i mirë për mungesën e perspektives dhe emigrimin masiv të të rinjve nga Kosova³².

Lëvizjet e lindshmërisë e sidomos e emigrimeve mund të konsiderohen shqetësuese të cilat kanë dhe do të kenë ndikim dhe efektet negative në shumë sfera të jetës duke përfshirë këtu edhe fushën e arsimit edhe në të ardhmen.

Rezultatet e parashikimeve të dinamikës së popullatës së Kosovës në dekadat e ardhshme tregojnë se sistemi arsimor do të përballet me sfida serioze të shkaktuara nga lëvizjet e pafavorshme demografike.

³¹ Islami H. (2012). ‘Aspekti etnik i migrimëve- Shqiptaret në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme’. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, fq 43.

³² Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë 2020, fq 71

Sipas Parashikimit të Popullsisë së Kosovës 2011-2061, sistemi arsimor i Kosovës në të ardhmen do të ballafaqohet me sfida edhe më serioze për shkak të tendencave të pavolitshme demografike të cilat në radhë të parë (sot) kanë goditur zonat kodrinore – malor, ndërsa në të ardhmen pritet të zgjerohen me zgjerimin e procesit të depopullimit.

Zvogëlimi i kontingjentit të popullsisë shkollore³³ - sipas parashikimit të popullsisë së Kosovës 2011-2061, kontingjenti i fëmijëve në shkollim fillor (6-14 vjet), në vitin 2031 do të jetë më i vogël për 90531 ndërsa në vitin 2061 për 181386 nxënës kështu që edhe pjesëmarrja e këtij kontingjenti do të zvogëlohet nga 17.6% (2011), në 11.5% (2031) dhe 7.5% (2061). Për pasoj në shkollat fillore të Kosovës në raport me vitin 2011, në vitin 2031 do të ketë rreth 4765, ndërsa në vitin 2061 rreth 9547 paralele më pakë (nëse llogaritet mesatarja 19 nxënës për paralele në vitin 2019).

Aspak më e mirë nuk do të jetë situata edhe me kontingjentin e shkollimit të mesëm (15-19 vjet). Popullsia e kontingjentit të shkollimit të mesëm në vitin 2031 do të jetë për 55076, ndërsa në vitin 2061 për 98799 nxënës më i vogël krahasuar me vitin 2011. Kështu edhe pjesëmarrja do të zvogëlohet nga 10.1% (2011), në 6.4% (2031) dhe 4.5% (2061). Kjo do të thotë se në vitin 2031 do të ketë rreth 2754, ndërsa në vitin 2061 rreth 4940 paralele më pak se sa në vitin 2011 (nëse llogaritet mesatarja 20 nxënës për paralele). Në të gjitha skenarët, përfshirë edhe atë më optimistin, zvogëlimi me te madhe relativ do të ketë pikërisht popullsisë në moshë shkollore. Gjendja do të jetë e njëjtë edhe sa i përket perspektives së numrit të studentëve në universitetet e Kosovës siç mund të shihet nga tabela në vazhdim.

Tabela 9. Perspektiva e numrit të të rinjve në periudhën fillestare të studimit 19 vjeç.

	Regjistrimi 2011	Projeksionet		Rritje/zvogëlim	
		2031	2061	2031	2061
Kosovë	35519	25198	16336	-29.1	-54.0

Reduktimi i kontingjentit të shkollimit do të përcjellët me reduktim të numrit të mësimdhënësve- do të duhen numër më i vogël i mësimdhënësve dhe do të kërkoj planifikim e shkollimit për mësimdhënës- do të reduktohen kuotat e regjistrimit në drejtimit arsimore. Gjithashtu kjo do të pasohet nga mbyllja e shumë shkollave nga i cili proces më të goditura do të jenë zonat rurale, proces ky i pranishëm në shumë vise kodrinore-malore të Kosovës, ku shumë shkolla karakterizohen me numër minimal të nxënësve ose edhe janë braktisur plotësisht.

Mbështetur në definicionin e Bankës Botërore, mund të konstatohet që sistemi arsimor i Kosovës është në fazën fillestare të paqëndrueshmërisë në zhvillimin e tij. Rezultatet e dinamikës së popullsisë së Kosovës në dekadat e ardhshme tregojnë se sistemi arsimor do të përballet me sfida serioze të shkaktuara nga tendencat e pafavorshme demografike, të cilat mund të ndikojnë veçanërisht në disponueshmërinë dhe cilësinë e arsimit, fenomene të cilat sot kanë goditur zonat kodrinore – malor, ndërsa në të ardhmen pritet të rriten me zgjerimin e krizës demografike dhe procesit të moshimit të popullsisë.

³³ Behrami S.et al. (2014) “Challenges of Kosovo Demographic Roadmap in the Future”. Facing Demographic Challenges. Volume B. Lubljana.

Përveç në sferën e arsimit pasoja të shumta negative nga zhvillimet e ardhshme demografike do të manifestohen edhe në sferën socio-ekonomike. Rritja e përshpejtuar e kontingjentit të popullsisë së moshuar- moshnimi demografik dhe zvogëlimi i kontingjentit të të rinjve do të ketë implikime negative në të gjitha sferat e jetës në Kosovë. Prandaj ***për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve, rajoneve, komunave etj., është e domosdoshme që në radhë të parë të sigurohet qëndrueshmëri demografike, çka e bënë qëndrueshmërinë demografike nënsistem të domosdoshëm të zhvillimit të qëndrueshëm së bashku me qëndrueshmërinë sociale, ekonomike dhe mjedisore.***

Një problem thelbësor në Kosovë dhe sistemin e saj arsimor është edhe mungesa e koordinimit midis arsimit dhe ekonomisë. Sistemi arsimor akoma prodhon kuadro të cilët pas përfundimit të shkollimit vështirë gjejnë punë në ekonominë e dobët kosovare. Kështu, struktura arsimore (edhe pse me shumë të meta) nuk është e kënaqshme dhe, si e tillë, nuk siguron që kapitali intelektual të shndërrohet në shtyllë të zhvillimit.

8.1.2. Institute dhe qendra kërkimore cilësore.

Vendet me ekonomi të suksesshme përveç popullsisë mirë të arsimuar dallohen nga cilësia e lartë e instituteve studimore, qendrave kërkimore dhe universiteteve, të cilat kryejnë dhe ofrojnë kërkime specifike që stimulojnë sipërmarrjen, orientojnë investimet publike e private, i hapin rrugë aplikimit të teknologjive nga më modernet, ndërtojnë platforma e politika zhvillimi etj. Veçori tjetër është simbioza e lartë e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe institucioneve që hartojnë e miratojnë politika zhvillimi me qendrat kërkimore shkencore³⁴.

Duhet theksuar se, në Kosovë, ende mungojnë institucione të specializuara për studime në shumë fusha siç është rasti me disa vende me traditë më të gjatë, kështu që është shumë e rëndësishme që në një të ardhme të afërt të formohen institucione të specializuara për problemet të ndryshme. Këtu në radhë të parë mendohet në themelimin e Qendrës për Kërkime Demografike.

³⁴ Adrian Civici, “Çfarë kërkon një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm”, <https://shtetiweb.org/2019/09/12/cfare-kerkon-nje-zhvillim-ekonomik-i-qendrueshem/>

9. DINAMIKA DHE SHKALLA E URBANIZIMIT E POPULLSISË NË KOSOVË

Urbanizimi është proces historik, kompleks dhe botëror i cili zhvillohet krahas me zhvillimin dhe ndryshimet e përgjithshëm shoqëror-ekonomik. Si proces kompleks urbanizimi është objekt i studimit shumë disiplinave shkencore prandaj edhe definicioni i tij varet nga aspekti i qasjes. Kështu nga aspekti demografik urbanizimi nënkuptohet si procesi i koncentrimin të popullsisë në qytete (zona urbane), nga aspekti urban fjala është për koncentrimin të funksioneve në një vendbanim, ekonomistet me urbanizëm nënkupton koncentrimin e fuqisë prodhuese në industri dhe veprimtaritë posindustriale, kurse nga aspekti sociologjik urbanizimi është proces i nivelit të zhvillimit shoqëror i cili përcjellët me ndryshime në mënyrën e jetës.

Te urbanizimi si proces botëror duhet dalluar dinamikën dhe shkallën e urbanizimit. Shumica e vendeve të zhvilluara karakterizohen me shkallë të lart të urbanizimit, ndërsa shtetet në zhvillim kanë shkallë të ulët të urbanizimit por karakterizohen me dinamika të shpejt të këtij procesi. Raporti midis popullsisë rurale dhe asaj urbane është indikator i rëndësishëm i nivelit të zhvillimit ekonomik e social dhe i ndarjes shoqërore të punës, si dhe i strukturës së popullsisë, intensitetit të procesit të deagrarizimit, deruralizimit dhe urbanizimit.

Urbanizimi si proces ka ndikim në shumë sfera të jetesë e gjithashtu ka ndikim edhe në sferën demografike. Është pranuar nga të gjithë, edhe në Konferencën Botërore të Popullsisë 1994, se urbanizimi i shpejt do të jetë tipari themelor në evolucionin e përgjithshëm demografik. Për urbanizëm në Kosovë mundë të flitet vetëm pas luftës së dytë botërore, pasi që në periudhat e më hershme si pasojë e zhvillimit të pamjaftueshëm e veçanërisht mungesës të industrializimit dhe transformimit të ngadalshmen hapësinor- funksional, shoqëria kosovare ishte pothuajse në tersi rurale ku popullsia rurale përbënte mbi 90% të popullsisë dhe po aq ishte e përfshi edhe popullsisë bujqësore.

Deri në vitet e '70 urbanizimi në Kosovë kishte tiparet e urbanizimit primar pasi që popullsia kryesisht ishte e orientuar drejt 7 qendrave regjionale në të cilat ishin të orientuara edhe 91.1% e investimeve të përgjithshme, duke rriten dallimet në zhvillimin ekonomik në mes 7 komunave – qendrave regjionale dhe pjesëve tjera të Kosovës. Vetëm pas viteve të '70 fillon një fazë e re në zhvillimin ekonomik, e cila në vitet e ardhshme ndikon në rritjen e shpejt të popullsisë urbane në qendrat e mesme e të vogla duke iniciuar fazën fillestare të urbanizimit sekondar (cilësor). Njohja me shkallën e urbanizimit është me rëndësi të shumëfishtë sepse shkalla më e lart e urbanizimit (në shumicën e rasteve) i përgjigjet shkallës më të lartë të zhvillimit ekonomik edhe e kundërta.

9.1. Vendbanimet urbane në regjistrimet e popullsisë

Problemi i parë me të cilin studiuesit ballafaqohen me rastin e studimit të popullsisë urbane është definimi i qyteteve ose ndarja e vendbanimeve në qytete dhe vendbanime të tjera.

Në praktiken ndërkombëtare nuk ekziston një kriteriumë i caktuar për definimin e vendbanimeve në urbane dhe të tjera prandaj numri i qyteteve dhe popullsisë urbane është nën ndikimin të drejtpërdrejt të kriteriumit i cili shfrytëzohet në rastin e ndarjes së vendbanimeve në urbane dhe të tjera. Në Kosovë në regjistrimet e popullsisë në periudhën pas luftës së dytë botërore janë shfrytëzuar dy kriteriume (modele) për ndarjen e vendbanimeve në urbane dhe të tjera:

- Administrativ- juridik sipas të cilit vendbanimet urbane janë përcaktuar me ligj dhe
- Kombinuar (demografikë-statistikor) i cili kishte për bazë kombinimin e dy karakteristikave të popullsisë : madhësinë e vendbanimit (numrin e popullsisë) dhe % e pjesëmarrjes së popullsisë jo bujqësore në popullsinë e përgjithshme.

Në bazë të kriterit të kombinuar të gjitha vendbanimet nën 2000 banor dhe me mbi 70% të popullsisë bujqësore janë kategorizuar në vendbanime rurale.

Numri i vendbanimeve urbane e më këtë edhe i popullsisë urbane në Kosovë në regjistrimet e popullsisë është i lidhur ngushtë me kriterin e përdorur për përcaktimin e vendbanimeve urbane. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1948, për definimin e vendbanimeve urbane është përdorur kriteriumi administrativ sipas të cilit vetëm 4 vendbanime ishin urbane.

Modeli i kombinuar për definimin e vendbanimeve është përdorur në regjistrimet e viteve 1953, 1961 dhe 1971. Në bazë të këtij modeli të gjitha vendbanimet ishin kategorizuar në tri grupe: vendbanimet rurale- fshatare, të përziere dhe urbane- qytete, duke pasur për bazë: madhësinë e vendbanimit dhe % e popullsisë jo bujqësore.

Madhësia e vendbanimit (nr.i popull.)	% e popullsisë jo bujqësore							
	Mbi 90%	80-89.9	70-79.9	60-69.9	50-59.9	40-49.9	30-39.9	Nën 30%
Nën 299	F	F	F	F	F	F	F	F
300-999	P	P	P	F	F	F	F	F
1000-1999	P	P	P	P	F	F	F	F
2000-2999	Q	P	P	P	P	F	F	F
3000-9999	Q	Q	Q	P	P	P	F	F
10000-14999	Q	Q	Q	Q	Q	Q	P	F
Mbi 15000	Q	Q	Q	Q	Q	Q	Q	P

Tabela 10. Skema për klasifikimin e vendbanimeve sipas kriterit të kombinuar

Vërejtje: F- Vendbanim rural (fshat), P- vendbanim i përziere dhe Q-vendbanim urban (qytet)

Me përdorimin e modelit të kombinuar numri i vendbanimeve urbane rritet nga 4 (1948) në 9(1953), 12 (1961) dhe 18 (1971). Pra në periudhën 1948-‘71 numri i vendbanimeve urbane rritet për 14 vendbanime të reja. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 për definimin e vendbanimeve përsëri kalohet në kriterin administrativo-juridik (me të cilën vendbanimi urban caktohet me vendim të organeve komunale) duke lëshuar kriterin e kombinuar. Në bazë të kriterit të ri të gjitha vendbanimet ndahen në urbane dhe të tjera.

Me ndryshimin e kriteriumit ndryshon edhe numri i vendbanimeve urbane nga 18 (1971) në 26 (1981) ose për 8 vendbanime urbane krahasuar me regjistrimin paraprak. Në këtë periudhë si pasojë

e ndryshimit të kriteriumit për definimin e vendbanimeve 3 vendbanime të cilat me kriteriumin e kombinuar kishin statutin e qyteteve me përdorimin e kriteriumit administrativo-juridik e humbin këtë statut (Bellaqevci i Madh, Janjeva dhe Graçanica).

Në regjistrimin e popullsisë së vitit 1991 regjistrim ky i bojkotuar nga popullsia shqiptare e Kosovës për definimin e vendbanimeve është përdorur kriteriumi administrativo-juridik numri i vendbanimeve urbane mbetet i njëjtë me atë të vitit 1981.

	Vendbanim urban-Qytet	Viti i regjistrimit						
		1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
1.	Baja					Q	Q	(X)
2.	Deçani					Q	Q	Q
3.	Dragashi					Q	Q	Q
4.	Drenasi					Q	Q	Q
5.	Gjilani		Q	Q	Q	Q	Q	Q
6.	Graçanica				Q	(X)	(X)	(X)
7.	Istogu					Q	Q	Q
8.	Janjeva		Q	Q	Q	(X)	(X)	(X)
9.	Kaçaniku			Q	Q	Q	Q	Q
10.	Klina					Q	Q	Q
11.	Fushë Kosova				Q	Q	Q	Q
12.	Kamenica					Q	Q	Q
13.	Mitrovica	Q	Q	Q	Q	Q	Q	Q
14.	Leposaviqi					Q	Q	Q
15.	Leshaku					Q	Q	X
16.	Lipjani				Q	Q	Q	Q
17.	Kastrioti			Q	Q	Q	Q	Q
18.	Rahoveci				Q	Q	Q	Q
19.	Peja	Q	Q	Q	Q	Q	Q	Q
20.	Podujeva				Q	Q	Q	Q
21.	Prizreni	Q	Q	Q	Q	Q	Q	Q
22.	Prishtina	Q	Q	Q	Q	Q	Q	Q
23.	Suhareka					Q	Q	Q
24.	Ferizaj		Q	Q	Q	Q	Q	Q
25.	Bella. i Madh				Q	(X)	(X)	(X)
26.	Vitia					Q	Q	Q
27.	Vushtrria		Q	Q	Q	Q	Q	Q
28.	Zveçani			Q	Q	Q	Q	Q
29.	Gjakova		Q	Q	Q	Q	Q	Q
30.	Skenderaj							Q
31.	Malisheva							Q
32.	Zubin Potoku							Q
33.	Shtërpca							Q
34.	Artana							Q
35.	Shtimja							Q
36.	Juniku							X
37.	Mamusha							X
38.	Hani i Elezit							X
39.	Ranillug							X
40.	Parteshi							X
41.	Kllokoti							X
	Gjithsejtë	4	9	12	18	26	26	30

Në vitin 2011 duke u bazuar në kriterin administrativo- juridik numri i vendbanimeve urbane rritet në 30, çka do të thotë se shumica e qendrave komunale janë llogaritur edhe qendra urbane.

Numri i vendbanimeve dhe i popullsisë urbane në Kosovë në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë i cili parashihet të organizohet në vitin 2021 do të varet nga kriteiumet të cilat do të përdoren për definimin e vendbanimeve e me këtë edhe popullsisë urbane në Kosovë.

Ne udhëzuesin (rekomandimet) për regjistrimin e popullsisë për vitin 2011 të përgatitur nga Komision Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën në bashkëpunim me Zyrën e statistikave të Bashkimit Evropian, përveç rekomandimeve për kategorizimin e vendbanimeve sipas madhësisë (nr. të banoreve), shteteve u rekomandohet që zonat urbane të definohen vendbanimet me mbi 2000 banor, kurse vendbanimet rurale me më pak se 2000 banor. Gjithashtu shteteve u lejohen mundësit për kombinimin edhe të elementeve tjera për definimin e zonave urbane.


9.2. Dinamika e rritjes së popullsisë urbane në Kosovë 1948- 2011

Në vitin 2011 vendbanimet urbane në Kosovë zënin më pak se 10% të sipërfaqes kurse në to jetonte 38.1% e popullsisë së Kosovës që tregon për një polarizim të theksuar të këtij fenomeni.


Sipas rezultateve të regjistrimeve të popullsisë deri në vitin 1991 të tri grupet e popullsisë (përgjithshme, urbane dhe rurale) karakterizohen me rritje të vazhdueshme, kurse në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, të tri grupet e popullsisë për herë të par ka treguar rënie krahasuar me regjistrimin paraprak, si pasoj e situatës së pavolitshme sociale, ekonomike, politike etj., në tri dekadat e fundit.

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	Rritja 1948/2011
Nr. pergj. i popullsisë	733034	815798	963988	1243693	1584441	2018500	1739825	137.4 % (2.4 here)
Popullsia urbane	71349	126139	187560	335019	514755	733700	661580	827.3% (9.3 here)
Popullsia rurale	661685	689769	776428	908674	1069686	1284800	1078239	62.9% (1.6 here)
Shkalla e urbanizimit	9.7	15.5	19.5	26.9	32.5	37.0	38.1	

Tabela 12. Dinamika e rritjes së popullsisë të përgjithshme, urbane, rurale dhe shkalla e urbanizimit në Kosovë 1948-2011



Grafikoni 11. Dinamika e rritjes së popullsisë të përgjithshme, urbane dhe rurale në Kosovë 1948-2011



Grafikoni 12. Pjesëmarrja e popullsisë urbane dhe rurale në popullsinë e përgjithshme në Kosovë 1948-2011

Dinamika e rritjes së tri grupeve të popullsisë në periudhën e caktuar ishte e ndryshme e cila varej nga niveli dhe trendët e zhvillimit ekonomik si dhe situata e përgjithshme politike. Sa here që Kosova kalonte nëpër fazat të qeta të zhvillimit pati rritje të popullsisë ndërsa në fazat e krizave ekonomike , politike dhe luftërave u shënuar dinamik me e ngadalshme ose edhe rënie e numrit të popullsisë.

	1948/53		1953/61		1961/71		1971/81		1981/91		1991/2011	
	Rr.abso	%	Rr.abso	%	Rr.abso	%	Rr.abso	%	Rr.abso	%	Rr.abso	%
Pop.pergj	82874	10.5	148080	15.4	279705	22.5	304748	21.5	434059	21.5	-278675	-35.8
Pop.urba.	54790	43.4	61421	32.7	147459	44.1	179736	34.9	218945	29.8	-72120	-67.1
Pop.rura.	28084	4.1	86659	11.2	132246	14.5	161012	15.1	215114	16.7	-206561	-4.1

Vërejtje: Për vitin 1953,'61 dhe '71 popullsia e vendbanimeve të përziera është llogaritur në kuadër të popullsisë rurale. Të dhënat i përpunoi autori.

Siç shihet nga tabela trendët më të shpejta të rritjes të tri grupet e popullsisë kishin në periudhën 1961-71 dhe 1971-81. Pas vitit 1981 popullsia urbane tregon rritje më të ngadalshme krahasuar me periudhat e më parme si pasojë e përkeqësimit të situatës ekonomike dhe politike në vend e cila u manifestua edhe me zvogëlimin e emigrimeve nga fshati në qytet që vazhdoi deri në periudhën e shpërthimit të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1999. Megjithatë, kjo është periudhë e emigrimeve intensive e cila u manifestua me zvogëlimin e tri grupeve të popullsisë mirëpo më e goditura ishte popullsia urbane që mund të konstatohet me trendin e kësaj popullsie gjatë periudhës 1991/2011 (shih tabelën 13).

Në përgjithësi në periudhën 63 vjeçare popullsia e përgjithshme ka treguar rritje për 137.4% (2.4 here), popullsia urbane për 827.3% (9.3 here) dhe popullsisë rurale për 62.9% (1.6 here). Në rritjen më të shpejt të popullsisë urbane në krahasim me popullsinë e përgjithshme dhe atë rurale pa dyshim që kanë ndikuar edhe emigrimet nga zonat rurale.

Kështu në përdhën 1961-1971 më tepër se gjysmën e rritjes së popullsisë urbane (57.2%) realizohej nga migrimet, ndërsa në përdhën 1971-'81 pjesëmarrja ulet në më pak se gjysmën e popullsisë (47.1%). Në dhjetëvjeçarin në vazhdim 1981-'91 pjesëmarrja e migrimeve në rritjen e përgjithshme të popullsisë urbane zvogëlohet në 34.2 % , pas që në këtë 10 vjeçar fillon ngecja e zhvillimit ekonomik dhe përkeqësimi i situatës politike e cila në fund të viteve të '90 eskloi në luftë të hapur.

	Vendbanimet urbane	Vendbanimet tjera
Rritja absolute		
1961-'71	147459	132246
1971-'81	179736	161011
1981-'91	215145	215114
Shtimi natyror		
1961-'71	62977	212157
1971-'81	95119	254764
1981-'91	131525-65.8%	273508
Saldoja migruese		
1961-'71	84482-57.2%	-79911
1971-'81	84617-47.1%	-93756
1981-'91	73620-34.2%	-58394

Tabela 13 . Rritja e popullsisë së përgjithshme, urbane dhe rurale në Kosovë në periudhën 1948-2004

Shtimin më të madh mekanik të popullsisë ne periudhën 1981-'91 e kanë shënuar vendbanimet urbane me 50.000-100.000 banor (36.8%) ndërsa me rritjen më të vogël e kishin qytetet deri 20.000 banor (28.0%) që tregojnë se popullsia që migroi kryesisht ishte orientuar drejt qendrave të mëdha (urbanizimi primar). Në favor të këtij konstatimi shkon edhe e dhëna e pjesëmarrjes në popullsinë urbane e 7 qendrave më të mëdha urbane pjesëmarrje e cila në vazhdimësi ka qenë shumë e lart. Kështu në vitin 1971 këto 7 qendra përbenin 81.2% të popullsisë urbane, 76.1% (1981), 75.2% (1991) dhe 73.9% (2011). Zvogëlimi e pjesëmarrjes në vitin 2011 tregon se edhe pas luftës së vitit 1999 popullsia në masën më të madhe ka emigruar edhe nga qendrat më të mëdha edhe pse koncentrimi i popullsisë drejt këtyre qendrave ka vazhduar edhe pas vitit 1999.

Edhe pse në vitin 1991 numri me i madh i vendbanimeve urbane i takonte vendbanimeve të vogla deri 20.000 banor (17) në to jetonin 124.274 banor që përbënte 6.3% të popullsisë së përgjithshme dhe 17% të popullsisë urbane. Në vendbanimet e mesme 20.000-100.000 (8), jetonin 450.121 banorë që përbënte 23 % të popullsisë së përgjithshme dhe 60.7% të popullsisë urbane, ndërsa në vendbanimet e mëdha mbi 100.000 (1) jetonin 155.499 banor ose 7.9% e popullsisë së Kosovës dhe 21.3% e popullsisë së përgjithshme urbane.

Në vitin 2011 në qendrat e vogla urbane (20) jetonin 121805 banor që përbënin 7% të popullsisë së përgjithshme dhe 18.4% të popullsisë urbane. Në vendbanimet e mesme (9) jetonin 378030 banor ose 21.7% e popullsisë së përgjithshme dhe 57.1% e popullsisë urbane, kurse në vendbanimet e mëdha urbane (1) jetonin 161751 banor që përbënin 9.3% të popullsisë së përgjithshme dhe 24.4% të popullsisë urbane të Kosovës.

Në krahasim me vitin 1991 në vitin 2011 vendbanimet e vogla urbane kanë treguar rënje të popullsisë për - 2%, ato të mesme për -16.1%, kurse ato të mëdha kanë treguar rritje për 4%. Zvogëlimi i pjesëmarrjes në popullsinë e përgjithshme urbane i vendbanimeve të vogla dhe të mesme dhe rritja e pjesëmarrjes nga vendbanimet e mëdha tregon për përfundimin e urbanizimit primar i cili si proces nuk shpreh zhvillim pozitiv të këtij fenomeni dhe është karakteristik e vendeve të pa zhvilluara.

9.3. Shkalla e urbanizimit të popullsisë

Si pasojë e dinamikës së ndryshme të rritjes së tri grupeve të popullsisë, ndryshojnë edhe niveli i pjesëmarrjes së popullsisë urbane dhe rurale në kuadër të popullsisë së përgjithshme. Për deri sa në vitin 1948 popullsia urbane përbente vetëm 9.7% në vitin 1981, 32.5% për të arritur në 38.1% në vitin 2011. Pra në vitin 1948 në qytete jetonte çdo i 10 banor në vitin 1981 çdo i 3, ndërsa në vitin 2011 gati çdo i 2.5 banor i Kosovës.

Edhe përkundër këtij trendi pozitiv Kosova karakterizohet me shkallë të ulët të urbanizimit në krahasim me vendet tjera evropiane. Për të treguar shkallën e urbanizimit të popullsisë së Kosovës do të përdoren kategorizimi i OECD-së i cili ka përdorim më të gjere ndërkombëtar për definimin dhe ndarjen e vendbanimeve në rurale dhe urbane i cili bazohet në dendësinë e popullsisë dhe % e pjesëmarrjes të popullsisë urbane ose rurale në popullsinë e përgjithshme.

Me qëllim të unifikimit të kriteriumit për rregullimin e njësive territoriale-administrative në korrik të vitit 1988 Këshilli i Evropës ka definuar Nomenklaturën e njësive statistikore (EEC Regulative No 2050/88) në Unionin Evropian (NUTS-Nomenclature des Unite's Territoriales Statistiques) e cila përdoret në të gjitha sferat shoqërore duke filluar nga : ekonomia, statistika, politika etj. i cili në vitin 2003 ka pësuar revidim dhe përmirësim.

Principet e NUTS bazohen në ndarjen hierarkike të shteteve në 5 nivele administrative (duke pasur për bazë numrin e popullsisë) : 3 në nivel regional dhe dy në nivel lokal.

Tabela 15. Kriteriumi i klasifikimit- NUTS

	<i>Minimumi</i>	<i>Maksimumi</i>	<i>Kosova</i>
NUTS 1	3.000.000	7.000.000	-
NUTS 2	800.000	3.000.000	Kosova si tersi
NUTS 3	150.000	800.000	7 regjionet dhe qyteti i Prishtinës
LAU 1 (NUTS 4)	10.000	150.000	Komunat 30
LAU 2 (NUTS 5)	Nën 10.000		Fshatrat 1469

Në kohet e fundit gjithnjë e më shpesh, nivelit regional i shtohet edhe niveli i 4, NUTS 0 i cili përfshin regjionet me mbi 7.000.000 banorë.

Një kategorizim i tillë edhe pse i definuar për vendet e Unionit Evropian, gjithnjë e më tepër po përdoret edhe nga vendet të cilat ende nuk janë pjesë e këtij unioni. Në bazë të definicionit të OECD-së në nivel lokal (LAU 1/2- komunat dhe fshatrat) klasifikimi i vendbanimeve në urbane dhe rurale bazohet në prapësinë e dendësisë së popullsisë prej 150 b/km², kurse në nivel regional (NUTS 1/2/3- 7 regjionet) OECD-ja definon 3 grupe të regjioneve në varësi të pjesëmarrjes së popullsisë urbane dhe rurale në popullsinë e përgjithshme:

1. -Kryesisht regjione rurale(mbi 50% e popullsisë së regjionit jeton në zonat rurale)
2. -Regjione të konsiderueshme rurale (15-50% e popullsisë së regjionit jeton në zonat rurale)
3. -Kryesisht regjione urbane(më pak se 15 % të popullsisë së regjionit jetojnë në zonat rurale.

Në bazë të kriteriumeve të OECD-së në vitin 2011 asnjë nga 7 regjionet e Kosovës nuk i takonte regjioneve urbane. Regjioni i Prishtinës që përbente 25.8% të popullsisë së përgjithshme dhe 31.8% të popullsisë urbane të Kosovës , me 57.6% të popullsisë urbane i takonte tipit të regjioneve të konsiderueshme rurale, kurse 6 regjionet tjera që përbenin 74.2% të popullsisë së përgjithshme i takonin regjioneve rurale me shkallë të urbanizimit në mes 37.4% deri në 46.4% të popullsisë urbane.

Pa marr parasysh cilëndo model të kategorizimit me të cilin shërbehemi komunat ekonomikisht të zhvilluara karakterizohen me shkallë më të lartë të urbanizimit si psh: Prishtina mbi 80% të popullsisë urbane, Prizreni 53.1%, Mitrovica 64.2%, Gjilani 60.1%, Ferizaj 39.3%, Peja 50.2%, Fushë Kosova 53.2 etj., ndërsa komunat me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik karakterizohen me shkallë të ulët të urbanizimit si p.sh ; Deçani 9.5%, Skenderaj 13.0%, Vitia 10.5%, Klina 15.3%, Drenasi 10.5%, Lipjani 11.9%, Malisheva 6.2%, Dragashi 3.3% etj. Lidhshmërinë në mes nivelit

të zhvillimit ekonomik dhe shkallës së urbanizimit e tregon edhe korolacioni i ngushtë i cili ekziston mes këtyre dy dukurive.

Procesi i urbanizimit të popullsisë në Kosovë është zhvilluar intensivisht që nga përfundimi i luftës së dytë botërore. Kështu pjesëmarrja e popullsisë urbane është rritur nga 9.7% (1948) në 38.1 (2011), kurse numri i popullsisë në vendbanimet urbane nga 71.3 mijë në 661.5 mijë banorë. Rritja e shpejt e popullsisë urbane para së gjithash është si rezultat i shtimit natyror dhe migrimëve të popullsisë nga vendbanimet rurale. Migrimet ndikimin më të madh në rritjen e popullsi urbane e kishin në periudhën 1961-'81 dhe në periudhën pas luftës së vitit 1999.

Edhe përkundër zhvillimit intensiv dhe rritjes të popullsisë urbane dhe shkallës së urbanizimit Kosova karakterizohet me:

- shkalle të ulët të urbanizimit, më të ulët në Evropë.
- dominon urbanizimi primar me koncentrimin e popullsisë në 7 qendrat më të mëdha urbane (79.1%), duke munguar urbanizimi kualitativ- urbanizimi sekondar.
- qytetet e vogla (nën 20.000 banor) të cilat përbejnë numrin më të madh të qyteteve (67 %), kanë shkalle të ulët të koncentrimin të popullsisë urbane(18.4%)
- qytetet e vogla në procesin e urbanizimit nuk kanë pjesëmarrjen adekuate konform pjesëmarrjes në numrin e përgjithshëm të vendbanimeve urbane.
- zhvillimi demografik i shpejt i qyteteve të mëdha , në të cilat kapacitetet janë të kufizuara (ekonomike, sociale, infrastrukturë etj) e vështirësojnë jetën e popullsisë por edhe zhvillimin e urbanizimit cilësor-sekondar.
- ndryshimet kualitative në urbanizëm nuk janë të mundshme pa zhvillimin më dinamik të qyteteve të vogla në të gjitha komunat , si dhe zhvillimin e qendrave të rangut më të ulët se sa qendrat komunale. Zhvillimi i qyteteve të vogla do të zvogëlonte lëvizjet migruese drejt qyteteve të mëdha çka do të mundësonte zhvillimin më të balancuar demografik dhe urbanizim ma kualitativ.

Rritja e shpejt e popullsisë urbane në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik në të cilën ndodhet Kosova dhe infrastruktura e dobët ka shkaktuar vështirësi për jetë në vendbanimet urbane (posaçërisht në qytete e mëdha dhe periferitë e tyre) që ka shkaktuar fenomenin e ruralizimit të qyteteve dhe është manifestuar me probleme të shumta të natyrës ekonomike, sociale, ekologjike dhe infrastrukturale.

Problemet ekonomike kanë të bëjnë me: papunësinë e lart në vendbanimet urbane, e cila përcjellët me rritjen e varfërisë, dhunës , kriminalitetit, ekonomia jo formale etj. Problemet sociale kanë të bëjnë me: ngarkesa e madhe te gjitha institucioneve në vendbanimet urbane(shkollave, shtëpive te shëndetit, kopshteve etj) dhe braktisja e atyre në fshatra.

Problemet ekologjike kanë të bëjnë me: shkalla e lart të ndotjes së parametrave mjedisor (ajrit, ujit, tokës) zhurma , problemet me mbeturina të ngurta urbane , numri i madh i automobilave etj.

Problemet në infrastrukturë kanë të bëjnë me: ndërtimet dhe mbindërtimet pa plan, zbrazja e fshatrave të tëra (sidomos territoret kodrinore- malore), ngarkesa e infrastrukturës urbane, problemet në furnizim me ujë të pijshëm, ngarkesa e rrjetit të rrugëve urbane etj. Për zgjidhjen e këtyre problemeve është e nevojshme përgatitja e planeve të mirëfillta zhvillimore dhe urbane të komunave dhe zonave brenda për brenda komunave si dhe përgatitja e një Strategjie të Zhvillimit të Urbanizimit në Kosovë.

Problemet demografike me të cilat do të ballafaqohet Kosova gjatë shek. XXI mund të parandalohen ose zbuten përmes politikave populatave. Politikat populatave mund të jenë: ekspansive (pronataliste), kufizuese (anti-nataliste), rishpërndarëse (e ekuilibruar) dhe kualitative ose eugjenike. Megjithatë, politika të mirë populatave nënkuptojnë një sistem masash që ndikojnë në proceset demografike (lëvizja natyrore dhe mekanike e popullsisë) në mënyrë që trendët e popullsinë të jenë në harmonizim me qëllimet ekonomike, sociale, politike dhe të tjera të zhvillimit të vendit.

Meqenëse, emigrimet janë faktori më i rëndësishëm në rënien ose stagnimin e popullsisë së Kosovës, është e nevojshme që shteti të veprojë në mënyrë që të ndikoj në zvogëlimin e shkaqeve që nxisin emigracionin. Kjo mund të arrihet me rritje të përpjekjeve për të zvogëluar pasigurinë ekonomike dhe psikologjike në përputhje me rrethanat, për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, krijimin e një atmosfere prosperiteti, të mbështesin programet shëndetësore dhe arsimore etj. Nëse shkaqet që nxisin popullsinë për emigrim nuk adresohen, masat tjera të orientuara në rritjen e lindshmërisë thjesht mund të rezultojë në më shumë njerëz që largohen nga vendi. Krijimi i kushteve për njerëzit e sidomos për rinin që të kenë besim në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre është çelës për ndalimin e krizës demografike në Kosovë. Nëse popullsia-njerëzit veçanërisht të rinjtë kanë qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor cilësor, nëse janë në punësim të qëndrueshëm dhe marrin mbështetje për rritjen e fëmijëve, ata kanë më pak gjasa të emigrojnë dhe kanë më shumë gjasa të vendosin të kenë fëmijë.

Gjithashtu është e rëndësishme të fokusohet edhe në sistemin e vlerave jo-materiale dhe rëndësinë e identitetit kombëtar dhe kulturor. Pastaj, është e nevojshme të ruhen kontakte me shoqata ose individë jashtë vendit, në mënyrë që të promovohet nevoja për t'u kthyer në vend dhe krijimin e lehtësirave për kthimin në vend. Sidoqoftë, nëse masat nuk janë të shpejta dhe efikase në një të ardhme vetëm zvogëlimi i emigracionit edhe masat e prezantuara me lart nuk do të jenë të mjaftueshme.

Meqenëse se Kosova gjatë gjithë historisë ishte dhe mbetet vend emigrues politika për tërheqje të emigrantëve nga vendet tjera është e pamundur, i cili si proces përcillet me probleme të shumta. Me qëllim të efikasitetit të politikave populatave në Kosovë, duhet të respektohen rekomandimet e demografëve eminentë të kohës të cilët theksojnë se qëllim kryesor i politikave populatave në këtë shekull duhet të jetë forcimi i bazës së resurseve njerëzore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal, regional e global³⁵, i cili nga këndvështrimi aktual i politikave në Kosovë do të jetë mjaft sfidues.

³⁵ Lutz, W (2014). 'A Population Policy Rationale for the Twenty- First Century'. Population and Development Review 40(3). fq 528.

PËRFUNDIME

Ndryshimet demografike me kaheje pozitive³⁶, duke përfshirë ndryshimet në madhësinë e popullsisë, strukturën e popullsisë sipas moshës, migrimet, urbanizimin, strukturën arsimore etj., janë faktorë i rëndësishëm për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi që ndikojnë në të gjitha objektivat e zhvillimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore të cilat adresohen në Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Agjendës 2030. Prandaj, për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve, rajoneve, komunave etj., është e domosdoshme që në radhë të parë të sigurohet qëndrueshmëri demografike.

Zhvillimi i qëndrueshëm demografik është parakusht thelbësor dhe qëllimi përfundimtar për qëndrueshmëri të shumë aktiviteteve njerëzore duke përfshirë edhe zhvillimin e qëndrueshëm, prandaj zhvillimi i qëndrueshëm ka kuptim vetëm nëse bëhet mënyrë jetese.

Lëvizjet negative demografike në shumicën e vendeve të zhvilluara (sidomos në Evropë) dhe atyre në zhvillim u manifestuan me zhvillime negative edhe në sferat tjera si në atë sociale, ekonomike, demografike, arsimore, politike e teknologjike etj., duke rrezikuar kështu zhvillimin e qëndrueshëm edhe në sferat tjera. Ndër problemet më të mëdha demografike të shumë vendeve të botës janë: rrënja e normës së lindshmërisë, depopullimi, moshnimi demografik etj.

Kosova edhe pse ende nuk karakterizohet me probleme të theksuar demografike, trendi në rënie i lindshmërisë dhe emigrimet për një periudhë të gjatë kohore kanë shkaktuar probleme të ndryshme në sfera të ndryshme të jetës duke përfshirë sferën demografike, socio- ekonomike, sistemin arsimor., të cilat në të ardhmen pritet të thellohen edhe më tepër.

Bazuar në të dhënat statistikore por edhe në parashikimet e popullsisë mundë të përfundohet se Kosova në të ardhmen pritet të përballet me sfida serioze, si pasoj e tendencave të pavoliteshme demografike të cilat do të reflektohen edhe në kualitetin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe plotësimin e objektivave të Agjendës 2030.

Me qëllim të shmangies dhe zvogëlimit të pasojave nga një zhvillim i tillë është jo vetëm e nevojshme por edhe e domosdoshme që të përgatiten politika të mirëfillta popullore me qëllim të ruajtjes së minimumit të rritjes së popullsisë për zhvillimit të qëndrueshëm edhe te sferave tjera të jetës duke përfshirë edhe sistemin socio- ekonomik. Nuk ka dyshim se proceset, dhe pasojat që rrjedhin prej trendëve të parapara demografike, përbëjnë një sfidë të madhe për popullsinë, politikën ekonomike, arsimore, sociale etj., të Republikës së Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm i cili si imperativ i botës bashkëkohore kërkon harmonizim në mes popullsisë- ekonomisë dhe mjedisit.

³⁶ United Nations Department of Economic and Social Affairs, Division for Sustainable Development, 2007: "UN Commission on Sustainable Development. Indicators of Sustainable Development": Guidelines and Methodologies. Center for International Development Harvard University, pp. 1-93.

European Commission. European Research Area, 2009: Sustainable Development Indicators. An Overview of relevant Framework Programme funded research and identification of further needs in view of EU and international activities, pp. 1-123. Marr nga: Prof. Dr. Bashkim Mal Lushaj " E Drejta Mjedisore Leksion për studentë dhe të tjerë me temë 2: "Zhvillimi i qëndrueshëm, kërkesë jetesore në kohët e sotme".

Ne fund, zhvillimet demografike kanë ndikim edhe në shumë sfera tjera socio-ekonomike, prandaj anashkalimi i proceseve demografike ose zhvillimi stihik (spontan) i tyre padyshim që do të çojë në një thellim të mëtejshëm të krizës demografike, ekonomike dhe sociale, e cila paraqet kërcënim për zhvillimin e qëndrueshëm dhe plotësimin Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm- Agjendës 2030.

Prandaj, zhvillim demografik dhe socio-ekonomik duhet të bazohen në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe si i tillë duhet të jetë pjesë e të gjitha dokumenteve dhe strategjive zhvillimore të vendit.

Zhvillimet demografike dhe pasojat e këtyre zhvillimeve si ato të tashme, ashtu edhe ato me të cilat do të përballet shoqëria kosovare në të ardhmen, nuk lejojnë qëndrimin indiferent të shoqërisë dhe shtetit me këto zhvillime por duhet të merren masa të menjëhershme të politikave popullore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm demografik dhe zhvillim të qëndrueshëm të përgjithshëm.

Ne rrugëtimin drejt plotësimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm- Agjendës 2030., përveç problemeve demografike, Kosova mund të ballafaqohet edhe me problemet tjera siç janë:

1. Mungesa e gatishmërisë së institucioneve vendore për adresimin e problemeve dhe sfidave demografike me ndikim në arrijten e objektivave të Agjendës 2030, për zhvillim të qëndrueshëm;
2. Vonesa në përgatitjen dhe implementimin e strategjive sektoriale në sferën demografike, ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
3. Kufizimi i buxhetit, e përforcuar nga kriza ekonomik, deficit i lartë i brendshëm, shkallë e lartë papunësia;
4. Ritmi i ngadaltë i reformave, lufta e ngadaltë kundër krimi të organizuar dhe korrupsioni;
5. Infrastruktura e dobët mjedisore dhe mos besimi i popullatës në institucionet shtetëror etj.

Kosovës dhe institucioneve të saj i mbetet shumë punë për të bërë në ngritjen dhe vetëdijesimin e opinionit për rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm edhe për faktin se shumë nga objektivat e këtij zhvillimi në të njëjtën kohe përbejnë edhe parakusht për Republikën e Kosovës për integritet Evropian.

REKOMANDIME

Zhvillimi i qëndrueshëm demografik mund të arrihet duke miratuar masa konkrete që do të inkurajojnë:

10.1. Sferën institucionale

1. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet Agjencisë së Statistikave, ministrive dhe organizatave të tjera, duke bërë përpjekje të përbashkëta për të forcuar dhe zgjeruar mbledhjen e të dhënave, cilësinë e parametrave demografik posaçërisht statistikave të migracionit;
2. Kuvendi i Kosovës është e nevojshme të krijoj një komision ekspertesh që do të merrte parasysh propozimet për nismat legislative në sferën demografike, që gjithashtu do të kishte parasysh ligjet e tjera nga aspekti i efekteve të tyre demografike dhe i cili do të përgatiste një strategji për përcaktimin e politikave të zhvillimit demografik;
3. Strategjia Kombëtare dhe të gjitha Strategjitë Sektoriale të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm specifikisht duke u bazuar në OZhQ.
4. Themelimi i Qendrës për Kërkime Demografike

10.2. Sferën demografike

1. Kosova momentalisht karakterizohet me rënie të shpejtë të lindshmërisë dhe trend të lartë të emigracionit. Me qëllim të shmangies së pasojave dhe përmbushje të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, zvogëlimi i emigrimeve do të duhej të jetë një nga detyrat kryesore të politikave demografike dhe ekonomike në periudhën e ardhshme;
2. Hulumtohen dhe adresimi i bashkëveprimi në mes tendencave demografike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivel regjional e lokal dhe adresimi i sfidave që do të vijnë nga zhvillimet e tashme dhe të ardhshme demografike;
3. Përgatitja e strategjive për parametrat demografik siç janë: strategjia për lindshmërinë, strategjia kombëtare e moshimit, strategjia kombëtare mbi migracionin etj, të cilat do të përgatiten nga grupe ekspertesh të fushave të ndryshme- multi diminsionale;
4. Siguruar që ndryshimet demografike të jenë me kaheje pozitive, minimalisht për ripërtëritje të thjeshtë të popullsisë ose zëvendësimi i brezave;
5. Siguruar zëvendësimin e popullsisë nëpërmjet modeleve të përshtatshme të zëvendësimit të shtimit natyror të popullsisë;
6. Angazhim me qëllim të krijimit të modelit të qëndrueshëm të migrimeve që ato të jen të rregullta, të sigurta dhe të përgjegjshme, që të mos shndërrohen në problem demografi, socio- ekonomik dhe të sigurisë siç janë zhvillimet e tanishme;
7. Krijimi i ekuilibërit demografik në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë; sigurimi i qëndrueshmëri në mes popullsisë ekonomikisht aktive dhe asaj pasive, qëndrueshmëri në kontingjentin e fuqisë punëtore përmes politikave të mirëfillta popullatave;

8. Fuqizimi i institucioneve kërkimore shkencore me qëllim të adresimit dhe zgjidhjes së problemeve të fushave të ndryshme duke përfshirë edhe çështjet demografike;
9. Stimulimi financiar të jetë masë themelore e politikës populatve për prindërit dhe qiftet e reja;
10. Politikave migratore duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë pasi ato kanë rëndësi të madhe në lëvizjet dhe zhvillimin demografik të Kosovës dhe do të jenë qenësor për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në funksion të plotësimit të OZHQ 10 respektivisht të treguesit 10.7, ndërsa përmes kërkesave për respektimin e të drejtave të punës dhe sigurimin në ruajtjen e identitetit për emigrant do të arrihet në plotësimin i treguesve 8.8 dhe 16.9.
11. Duhet të krijohen politika të popullsisë, të cila jo vetëm që mund të kontrollojë rritjen e popullatës, por gjithashtu mund të parandalojë plakjen e tepërt të popullatës e cila do të shndërrohet në pengës për ekonominë e vendit dhe zhvillim të qëndrueshëm përmes : produktivitetin më të ulët të punës, rritjes së kontingjentit të popullsisë jo aktive (të varur), ngarkesë në sistemin social, shëndetësor, sigurimeve etj.
12. Plakja e popullsisë do të shtojë sfida të reja për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë kështu që çështjet që lidhen me plakjen e popullsisë duhet përfshihen në fusha të ndryshme të politikave p.sh :
 - a. Krijimi i sistem të qëndrueshëm të sigurimeve dhe zhvillimit ekonomik në përshtatje me trendet e plakjes së popullsisë;
 - b. Sigurimi shoqëror i personave të moshuar për të parandaluar varfërinë;
 - c. Strategji e plakjes së shëndetshme dhe aktive;
 - d. Strategjia për mësimin gjatë gjithë jetës, fuqizimin përmes arsimit pas jetës në punë;
 - e. Iniciativa e punësimit 65+ dhe menaxhim i punës midis brezave
 - f. Shtesa dhe beneficione për përfituesit e pensioneve të vogla në veçanti për grat e moshuara shumica e të cilave gëzojnë pensione pleqërie etj.

10.3. Sferën socio- ekonomike

1. Një ekonomi e fort që siguron vende pune dhe të ardhura të qëndrueshme me qëllim të krijimit të kushteve për njerëzit e sidomos për rinin që të kenë besim në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre që është çelës për ndalimin e krizës demografike;
2. Shërbime të përballueshme dhe cilësore për fëmijë, të rinjë dhe të moshuarit;
3. Nëse popullsia- njerëzit, veçanërisht të rinjtë kanë qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor cilësor, nëse janë në punësim të qëndrueshëm dhe marrin mbështetje për rritjen e fëmijëve, ata kanë më pak gjasa të emigrojnë dhe kanë më shumë gjasa të vendosin të kenë fëmijë.
4. Përkrahje financiare për familjet posaçërisht për ato me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura e me numër të madh të anëtareve etj;
5. Të përmirësohet klima e investimeve, duke tërhequr më shumë investimet e emigrantëve dhe të inkurajohet zhvillimi i sektorit privat, duke zgjeruar mundësinë e financimeve, duke rritur aftësinë e bankave për t'i ofruar kredi sektorit privat me

interes të kënaqshëm nga pala e emigrantëve apo emigrantëve të kthyer në vendlindje;

6. Të kufizohet fluksi i lartë i emigracionit dhe të kanalizohen remitancat nga konsumi në investime dhe aktivitete prodhuese duke ndërmarrë politika shumëpalëshe të cilat nxisin rikthimin e emigrantëve për të investuar të ardhurat e tyre në vendlindje.
7. Të krijohet një bazë të dhënash mbi diasporën kosovare për një mbështetje më të madhe ndaj emigrantëve dhe sigurimin e një kontributi më të madh të tyre për zhvillimin ekonomik të Kosovës nëpërmjet remitancave të tyre dhe aftësive të tyre të përfituara nga puna e kryer në vendet pritëse;
8. Sistemi arsimor duhet të përshtatet dhe të harmonizohet me tregun e punës për të ndihmuar njerëzit të gjejnë punë. Kjo arrihet me regjistrimin e nxënësve në profilet arsimore për të cilat ka nevojë tregu i punës duke koordinuar dhe krijuar platforma të përbashkëta të punësimit në mes zyrave të punësimit, Odave të Bizneseve, Qendrave të Aftësimit Profesional, Institucionet tjera arsimore etj. ;
9. Përfshirja dhe prezantimi më i madhë i çështjeve demografike në materialet shkollore sidomos në ato universitare;
10. Të rishikohen dhe të shtohen përmbajtjet demografike në programet dhe tekste mësimore të shkollës fillore dhe të mesme dhe të propozohen ndryshimet e duhura duke përfshirë në kapituj të veçantë tema që kanë të bëjnë me çështje demografike;
11. Shqyrtimi i mundësive futjen e një lëndë të veçantë për popullsinë në arsimin e mesëm (në vitin IV të shkollave të mesme);
12. Një zhvillim më i ekuilibruar rajonal me qëllim që të frenohet eksodi i popullsisë së zonave rurale drejt atyre urbane;
13. Orientimi drejt urbanizimit policentrik si model i urbanizimit bashkëkohor;
14. Përgatitja e Strategjisë Urbane për orientim të prioriteteve dhe politikave me qëllim të shmangies të problemeve të cilat sjell urbanizimi stihik;
15. Fokusimi në zonat ku urbanizimi është i shpejtë ndërsa kapacitetet janë të kufizuara;
16. Shfrytëzimi i eksperiencave nga vendet tjera te cilat janë ballafaquar me sukses me sfidat të njëjta.

www.indep.info